



Republika e Kosovës
Republika Kosova | Republic of Kosovo



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova | Kosovo Judicial Council

**RAPORTI I PUNËS PËR SISTEMIN GJYQËSOR
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

2023



Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Publikuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

LISTA E SHKURTESAVE

KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
SKGJK	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
NJIGJ	Njësia për Inspektim Gjyqësor
GJS	Gjykata Supreme
DHPGJS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
GJA	Gjykata e Apelit
GJK	Gjykata Komerciale
GJTH	Gjykata Themelore
TIK	Teknologji Informative dhe Komunikim

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS	4
1.1 Vizioni	4
1.2 Misioni	4
1.3 Mandati	5
1.4 Përbërja e Këshillit	6
2. AKTIVITETET E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS	7
2.1 Takimet e KGJK-së	7
2.2 Emërimi i kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës	7
2.3 Avancimi i gjyqtarëve	7
2.4 Rekrutimi i gjyqtarëve	7
2.5 Rekrutimi i bashkëpunëtorëve profesional	7
2.6 Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve	8
2.7 Miratimi i akteve nënligjore	8
2.8 Transferimi i gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional	8
2.9 Procedura disiplinore e gjyqtarëve	8
2.10 Bashkëpunimi Institucional i Këshillit	9
3. ZYRA E KRYESUESIT TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS	11
3.1 Aktivitetet e Kryesuesit	11
3.2 Njësia për Auditim të Brendshëm	13
3.3 Zyra për Komunikim me Media dhe Publikun	14
PJESA E DYTË	16
4. KOMISIONET E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS	16
4.1 Komisioni për Çështje Normative	17
4.2 Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve	20
4.3 Komisioni për Administrimin e Gjykatave	22
4.4 Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel	24
4.5 Komisioni për Trajnime	25
5. KOMISIONI PËR KOMPENSIMIN E DËMIT PËR PERSONAT E DËNUAR OSE ARRESTUAR PA ARSYE	26
6. ASAMBLEJA E KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS	27
7. KOMITETI KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE	28
8. PANELI PËR LIRIM ME KUSHT	29
9. PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA	30

PJESA E TRETË

31

10. VEPRIMTARIA E GJYKATAVE	32
10.1 Gjykata Supreme	32
10.2 Gjykata e Apelit	34
10.3 Gjykata Komerciale	35
10.4 Gjykata Themelore Prishtinë	37
10.5 Gjykata Themelore Gjilan	39
10.6 Gjykata Themelore Prizren	40
10.7 Gjykata Themelore Gjakovë	42
10.8 Gjykata Themelore Pejë	43
10.9 Gjykata Themelore Ferizaj	45
10.10 Gjykata Themelore Mitrovicë	46

PJESA E KATËRT

48

11. AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS	48
11.1 Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit	48
11.2 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	49
11.3 Zyra për Integritet Evropian	52
11.4 Zyra për Përkthime	53
11.5 Departamenti për Teknologji Informativ	53
11.6 Departamenti për Logjistikë dhe Infrastrukturë	54
11.7 Departamenti për Çështje Ligjore	58
11.8 Departamenti për Buxhet dhe Financa	60
11.9 Departamenti i Prokurimit	61
11.10 Departamenti i Evidencës Qendrore Penale	63
12. AKTIVITETET E NJËSISË PËR INSPEKTIM GJYQËSOR	65
12.1 Zyra e Drejtorit të Njesisë	65
12.2 Zyra për Statistika	65
12.3 Zyra për Vlerësim dhe Verifikim	67
12.4 Zyra për Performancë dhe Inspektim	68
12.5 Zyra për Disiplinim	69

PJESA E PESTË

70

13. BUXHETI I KËSHILLIT GJYQËSOR	70
13.1 Shpenzimet	70
13.2 Të hyrat gjyqësore	74

PJESA E GJASHTË

75

14. TË ARRITURAT DHE SFIDAT E SISTEMIT GJYQËSOR	75
14.1 Përmbushja e Planit të Punës	75
14.2 Sfidat	79

PJESA E PARË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i punës për vitin 2023 paraqet dokumentin kryesor lidhur me veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), si institucion kushtetues i cili siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.

Ky raport është i ndarë në gjashtë pjesë, ku është pasqyruar në mënyrë të përgjithësuar tërë veprimtaria e Këshillit Gjyqësor të Kosovës sipas organizimit dhe funksionimit të vet ligjor, duke përfshirë edhe gjykatat.

Pjesa e parë përmban informata të përgjithshme për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe aktivitetet gjatë këtij viti, duke përfshirë edhe aktivitetet e zyrës së Kryesuesit të KGJK-së.

Në pjesën e dytë, përshkruhet veprimtaria dhe aktivitetet e Komisioneve të KGJK-së, Asamblesë së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, Panelit për Lirim me Kusht si dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Në vijim të raportit, në pjesën e tretë të tij, përshkruhen aktivitetet dhe të arriturat e gjykatave me degët përkatëse të tyre duke vazhduar në pjesën e katërt me paraqitjen e aktiviteteve të Sekretariatit të KGJK-së dhe Njësisë për Inspektim Gjyqësor.

Pjesa e pestë paraqet të dhënat kryesore lidhur me buxhetin e sistemit gjyqësor për vitin 2023, përkatësisht shpenzimet dhe të hyrat gjyqësore, ndërsa pjesa e gjashtë përfshin të arriturat dhe sfidat e gjyqësorit.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mandatin e tij e ushtron në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe akteve përkatëse nënligjore. Ndërsa, me Ligjin për Gjykatat është rregulluar organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i gjykatave në Republikën e Kosovës.

1.1 VIZIONI

Një sistem gjyqësor i pavarur, i qasshëm për të gjithë, i drejtë dhe efikas në punën e tij, që jep llogari në punën e vet, që është funksional dhe që u përmbahet standardeve më të larta të integritetit, profesionalizmit, kompetencës, efikasitetit dhe transparencës.

1.2 MISIONI

Të krijohet dhe të ruhet një sistem gjyqësor i pavarur, që ofron shërbime gjyqësore të paanshme për të gjithë pa dallim dhe që është funksional në të gjitha aspektet organizative dhe operative.



1.3 Mandati

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, mandati i KGJK-së është si vijon:


- Vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të gjykatave sipas ligjit;
- I propozon Presidentit emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, si dhe siguron se të gjithë kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj, sipas procedurave përkatëse ligjore;
- I propozon Presidentit emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, siguron se kandidati i propozuar i plotëson kriteret e përcaktuara me ligj dhe janë zhvilluar procedurat përkatëse;
- I propozon Presidentit emërimin e gjyqtarëve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Vendos për përzgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, Kryetarit të Gjykatës Komerciale, të kryetarëve të gjykatave themelore dhe gjyqtarëve mbikëqyrës;
- Siguron zbatimin dhe mbikëqyrë kriteret për praninë në gjyqësor, të cilat duhet të bëhen në pajtim me parimet e meritës, mundësive të barabarta, barazisë gjinore, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve;
- Vendos për shpalljen e konkurseve për kandidatët për pozita në gjyqësor;
- Vendos për organizimin e provimit për kandidatët për gjyqtarë sipas rregullores së miratuar nga Këshilli;
- Vendos dhe mbikëqyrë zbatimin e kriterëve për përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse dhe për plotësimin e vendeve të lira të punës, të garantuara për anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
- Vendos për numrin e gjyqtarëve në secilin juridiksion;
- Rekomandon themelimin e gjykatave të reja dhe degëve të gjykatave, në pajtim me Ligjin për gjykatat;
- Administron gjyqësorin dhe bën inspektim gjyqësor;
- Harton dhe mbikëqyrë buxhetin për gjyqësorin;
- Vendos për avancimin, transferimin dhe disiplinimin e gjyqtarëve;
- Vendos kriteret për vlerësimin e rregullt të gjyqtarëve;
- Vendos për ngarkesën me lëndë të gjykatave;
- Siguron funksionimin efikas të gjykatave;
- Vendos dhe mbikëqyrë kriteret për përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve lidhur me trajnimin e gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe personelit tjetër gjyqësorë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit profesional të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë;

- Miraton Kodin e Etikës Profesionale për anëtarët e Këshillit, gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë si dhe Kodin e Etikës për stafin administrativ gjyqësor, shkelja e të cilit është bazë për sanksione, përfshirë shkarkimin nga funksioni;
- Vendos për miratimin e skemës unike të taksave gjyqësore të zbatueshme në mbarë territorin e Republikës së Kosovës;
- Siguron menaxhimin e sistemit qendror të evidencës penale sipas rregullores së miratuar nga Këshilli;
- Miraton raportin vjetor mbi veprimtaritë e gjykatave dhe shpenzimet e buxhetit për gjyqësorin;
- Bashkëpunon me këshillat gjyqësore të shteteve të tjera dhe organizatat përkatëse vendore dhe ndërkombëtare, me kusht që të mos ndikojë në pavarësinë e punës së tij;
- Miraton aktet nënligjore në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësi të tij, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

1.4 Përbërja e Këshillit

KGJK sipas legjislacionit në fuqi, në përbërjen e tij ka 13 anëtarë: 7 anëtarë zgjedhën drejtpërdrejt nga gjyqësori, ndërsa 6 anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Mandati i anëtarëve të Këshillit është 5 vjeçar.

Në vitin 2023, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka zgjedhur 2 anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me ç'rast në fund të vitit raportues, Këshilli në përbërjen e vet kishte 12 anëtarë, që nënkupton se, 1 pozitë nuk është plotësuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.



2. AKTIVITETET E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me qëllim të përmbushjes së mandatit të vet kushtetues dhe ligjor gjatë vitit 2023 ka realizuar një sërë aktivitete.

2.1 Takimet e KGJK-së

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka mbajtur 28 takime, përfshirë këtu takimet e jashtëzakonshme dhe takimet e mbajtura në formë elektronike. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Këshilli ka nxjerrë gjithsejtë 568 vendime.

2.2 Emërimi i kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës

Presidentja e Republikës së Kosovës ka emëruar Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, pas propozimit të KGJK-së. Gjatë kësaj periudhe, KGJK ka emëruar gjyqtarët mbikëqyrës në degët: Fushë Kosovë dhe Graçanicë.

2.3 Avancimi i gjyqtarëve

Këshilli ka avancuar 3 gjyqtarë në Gjykatën e Apelit, 2 gjyqtarë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe 3 gjyqtarë në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

2.4 Rekrutimi i gjyqtarëve

KGJK ka përfunduar procesin e rekrutimit të 37 pozitave të shpallura për gjyqtarë në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës, prej të cilëve 29 kandidatë janë propozuar për dekretim tek Presidentja e Republikës së Kosovës, me ç'rast janë dekretuar nga e njëjta. Po ashtu, KGJK ka përfunduar procesin e rekrutimit edhe për 47 pozita të shpallura për gjyqtar, ku pas përfundimit të procedurave rekrutuese, 15 prej tyre janë propozuar për dekretim te Presidentja.

Gjithashtu, Këshilli ka emëruar 85 gjyqtarë porotë, pas përfundimit të procedurave rekrutuese në gjykatat përkatëse.

2.5 Rekrutimi i bashkëpunëtorëve profesional

Këshilli ka përfunduar procesin e rekrutimit të 50 bashkëpunëtorëve profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës.



2.6 Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve

Këshilli ka përfunduar vlerësimin e performancës së 161 gjyqtarëve.

2.7 Miratimi i akteve nënligjore

Këshilli ka miratuar 28 akte nënligjore.

2.8 Transferimi i gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional

Këshilli ka transferuar 4 gjyqtarë, ndërsa ka transferuar 19 bashkëpunëtor profesional.

2.9 Procedura disiplinore e gjyqtarëve

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka pranuar gjithsejtë 123 njoftime për pranim të ankesave disiplinore të paraqitura nga personat fizik dhe juridik ndaj gjyqtarëve, ankesa këto të trajtuara nga autoritet kompetente dhe Këshilli. Nga njoftimet e pranuar, autoritetet kompetente kanë nxjerr 105 vendime përmes të cilave kanë ankesat janë refuzuar.

Po ashtu, Këshilli ka pranuar nga autoritetet kompetente edhe 7 kërkesa për fillim të hetimit disiplinor, prej të cilave:

- 2 kërkesa kanë rezultuar nga ankesat e paraqitura në fund të vitit 2022 dhe
- 5 kërkesa nga ankesat e paraqitura gjatë vitit 2023.

Pas shqyrtimit të këtyre kërkesave për fillim të hetimeve disiplinore, Këshilli ka themeluar 5 panele hetimore, ndërsa për 2 kërkesa për fillim të hetimeve ka bashkuar procedurën me një panel hetimor të themeluar në fund të vitit 2022.

Këshilli ka pranuar 3 raporte nga panelet e themeluara gjatë vitit 2023 dhe 7 raporte mbi faktet dhe provat e mbledhura nga panelet e themeluara në fund të viti 2022, ku për shqyrtimin e këtyre 10 raporteve, KGJK ka mbajtur 20 seanca dëgjimore, duke vendosur si në vijim:

- 1 vendim: Zvogëlim i përkohshëm i pagës në lartësi prej 40% për 4 muaj;
- 4 vendime: Lirim nga përgjegjësia disiplinore;
- 2 vendime: Propozim për shkarkim;
- 2 vendime: Vërejtje publike me shkrim;
- 1 vendim: Transferim i përhershëm nga Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal i Gjykatës Themelore në Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni për Kundërvajtje i të njëjtës gjykatë.

Duke marr parasysh afatet dhe procedurat ligjore, 2 raporte mbi faktet dhe provat e mbledhura janë bartur për shqyrtim për vitin 2024.

2.10 Bashkëpunimi Institucional i Këshillit

Me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të ndryshme që lidhen me punën e gjyqësorit, KGJK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si:

- ▶▶ Deklarata e Përbashkët e Zotimit dhe Plani i Veprimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit
- ▶▶ Amandamenti i Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- ▶▶ Marrëveshje granti ndërmjet Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- ▶▶ Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Dexis Consulting Group, zbatues i Programit për Drejtësi Komerciale i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar në Kosovë dhe KGJK
- ▶▶ Memorandum mirëkuptimi për ndryshimin dhe plotësimin e memorandumit të mirëkuptimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit
- ▶▶ Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës rreth pilot projektit 'Thirrjet elektronike të dërguara përmes postës elektronike nga gjykata tek Komuna e Prishtinës'
- ▶▶ Memorandum mirëkuptimi ndërmjet KGJK-së dhe Programit të Bashkimit Evropian për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë 'Përmirësimi i cilësisë së të dhënave dhe ndërveprimit të SMIL me SQEP'
- ▶▶ Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Demokraci Plus dhe KGJK-së
- ▶▶ Marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet KGJK-së dhe Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës

KGJK ka organizuar **'Ditët e Gjyqësorit'** me gjykata, të cilat janë mbajtur gjatë 5 ditëve. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte vlerësimi i gjendjes së sistemit gjyqësor, përfshirë të arriturat, përmbushja e planeve të punës, sfidat si dhe objektivat strategjike për avancimin e gjyqësorit.

Gjatë këtyre aktiviteteve janë ftuar përfaqësues nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me ç'rast ndër të tjera është diskutuar për reformën në drejtësi (Gjykata Administrative, Kodi i Procedurës Civile, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme); forcimin e mekanizmave të brendshëm (sistemi i performancës së gjyqtarëve, sistemi i disiplinimit, verifikimi/kontrolli i integritetit, zhvillimi i shkathtësive, statusi i gjyqtarëve, statusi i administratës gjyqësore); efikasitetin e gjyqësorit; cilësinë e vendimmarrjes; besimin e publikut dhe sfidat e gjyqësorit.



DITËT E GJYQËSORIT 2023



3. ZYRA E KRYESUESIT TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës përfaqëson Këshillin para publikut, agjencive qeveritare dhe organeve të tjera publike. Po ashtu, Kryesuesi mbikëqyrë dhe menaxhon punën e Këshillit dhe komisioneve të tij, përfshirë edhe gjykatat. Në mungesë të Kryesuesit autoritet të plotë për të vepruar në emër të Këshillit ka zëvendës kryesuesi.

Zyra e Kryesuesit mbështetet nga kabineti i cili përbëhet nga kategoria e veçantë e zyrtarëve siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Po ashtu, në kuadër të Zyrës së Kryesuesit funksionon edhe:

- Njësia për Auditim të Brendshëm
- Zyra për Komunikim me Media dhe Publikun.

3.1 Aktivitetet e Kryesuesit

Kryesuesi në kuadër të mandatit të tij, ka zhvilluar aktivitete duke ndërmarrë iniciativa dhe koordinuar procese me rëndësi në fushën e reformave dhe në promovimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor.

Kryesuesi ka vazhduar bashkëpunimin me ambasadorë, përfaqësues nga ambasadat, organizatat partnere, donatorët zhvillimor të cilët e mbështesin sistemin gjyqësor, duke përfshirë Misionin e EULEX-it, Zyrën e Bashkimit Evropian, Këshilli i Evropës, INL, USAID, OSBE, UNDP, si dhe projektet aktive si EUKOJUST, WBROLI dhe të tjera.

Po ashtu, Kryesuesi ka zhvilluar edhe më tutje koordinimin me Asamblenë e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, si dhe ka mbajtur takime të rregullta me menaxhmentin e gjykatave, si dhe stafin mbështetës të tyre.

Me qëllim të bashkëpunimit me institucionet vendore, kryesuesi ka zhvilluar takime me: Këshillin Prokurorial të Kosovës, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Avokatin e Popullit, Policinë e Kosovës dhe institucione të tjera. Kryesuesi ka vazhduar bashkëpunimin edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë si dhe Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë.

Kryesuesi ka përfaqësuar gjyqësorin edhe në konferenca dhe punëtori ndërkombëtare të organizuara jashtë vendit si: vizitë studimore në SHBA lidhur me përvetësimin e praktikave më të mira në menaxhimin efikas të lëndëve gjyqësore. Po ashtu, Kryesuesi ka prezantuar para Këshillit të Përhershëm të OSBE-së në Vjenë rolin dhe të arriturat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe vizionin për konsolidimin e efektivitetit dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor.

Lidhur me iniciativën e përbashkët në mes të KGJK-së, Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatës Supreme, kryesuesi ka pasur rol koordinues ndër-institucional sa i përket reformave në fushën e drejtësisë, përfshirë inicimin e hartimit të Kodit të Procedurës Civile, projektligjin për Gjykatën Administrative dhe projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Kryesuesi ka mbrojtur në vazhdimësi qëndrimet e KGJK-së, në raport me iniciativat e Ministrisë së Drejtësisë për procesin e Vettingun dhe iniciativat tjera, sa i përket aspekteve kushtetuese dhe ligjore për pavarësinë e gjyqësorit.



3.2 Njësia për Auditim të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm, vepron sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe statutit të saj.

Njësia ka përfunduar të gjitha auditimet e planifikuara, lidhur me:

- Menaxhimin e shpenzimeve për ekspert, avokat, gjyqtar porotë dhe kthim të depozitave gjyqësore në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Ferizaj dhe Prizren, me degët e tyre;
- Menaxhimin e transportit në Departamentin e Logjistikës dhe Infrastrukturës në SKGJK, Gjykatën Themelore në Gjiilan dhe Prizren, me degët e tyre;
- Menaxhimin e shpenzimeve dhe blerjeve për paisje të TI-së të Departamentit të TI-së në SKGJK dhe zyrtarët e TI-së në gjykata;
- Menaxhimin e pasurisë jo financiare në Departamentin për Buxhet dhe Financa në SKGJK, Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Ferizaj me degët e tyre;
- Menaxhimin e procedurave të prokurimit për investime kapitale në Departamentin e Prokurimit në SKGJK.

Njësia ka realizuar auditimin e përcjelljes së ekzekutimit të pagesave për ekspert gjyqësor, avokatë sipas detyrës zyrtare, gjyqtarë porotë dhe kthimi i depozitave gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Pejë dhe Gjiilan, me degët e tyre.

Njësia ka hartuar Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2024-2026 dhe Planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2024, duke dorëzuar te Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave. Po ashtu, ka realizuar planin e punës për vitin 2023 duke përfunduar 10 raporte të auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, ka mbajtur takime me qëllim të mbikëqyrjes së planeve, raporteve dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

Njësia ka realizuar vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

3.3 Zyra për Komunikim me Media dhe Publikun

Zyra për Komunikim me Media dhe Publikun e KGJK-së ka siguruar transparencë dhe qasje publike për punën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës duke ofruar informata të nevojshme dhe qasje në dokumentet publike me kërkesë të qytetarëve, mediave dhe OJQ-ve.

Me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve me median dhe publikun, për një komunikim sa më efikas dhe sa më transparent në sistemin gjyqësor, janë trajtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, për të cilat është raportuar në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, për vitin 2023.


Faqja e internetit është përditësuar me informacione lidhur me aktivitetet e KGJK-së, njoftime, raporte, vendime dhe dokumente përkatëse. Gjithashtu, është punuar që ueb faqja t'i përshtatet përdoruesve dhe publikut për qasje më të lehtë për marrjen e informatave të nevojshme si në faqen zyrtare të KGJK-së, ashtu edhe në rrjetin social, Facebook.

+14,000 ndjekës total në faqen zyrtare të KGJK-së në Facebook



Janë publikuar gjithsejtë, 268 komunikata dhe njoftime, të cilat janë ndarë edhe në faqen zyrtare në Facebook.

Më poshtë, gjeni të dhëna demografike që bazohen në moshën dhe gjininë që ndjekësit e faqes ofrojnë në profilet e tyre si dhe top 3 lokacionet nga të cilat vijnë:




KGJK në bashkëpunim me projektet e USAID, 'Aktiviteti për Drejtësi' dhe 'Drejtësia Komerciale' ka publikuar video shpjeguese dhe materiale udhëzuese, grafika dhe raporte të ndryshme, të cilat ndërlidhen me mesazhe për qytetarët për marrjen e informacioneve dhe shërbimeve brenda gjykatave, si dhe informatave rreth gjyqësorit në përgjithësi.



Zyra, përveç kërkesave të vazhdueshme të mediave të shkruara dhe vizuale, i'u është përgjigjur në total 907 kërkesave të organizatave joqeveritare që punojnë dhe veprojnë në Kosovë, të cilat monitorojnë punën e sistemit gjyqësor. KGJK ka vazhduar bashkëpunimin intensiv me këto OJQ-ve, duke filluar nga IKD, GLPS, Lëvizja Fol, BIRN, KDI, AVONET, YIHR-KS, INJECT, etj.

Të dhëna rreth profilit të kërkesave



Është ngritur bashkëpunim ndërinstytucional në fushën e komunikimit me të gjitha institucionet e vendit që janë zbatuese të ligjit, ku edhe janë prezantuar aktivitete të përbashkëta e që janë me interes për qytetarët e vendit.

PJESA E DYTË

4. KOMISIONET E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Këshilli realizon mandatin e vet përmes komisioneve të përhershme, atyre që themelohen për një mandat të caktuar ad-hoc dhe komisionet e tjera që parashihen me legjislacionin në fuqi.

Të gjitha komisionet e përhershme të cilat funksionojnë në kuadër të Këshillit, kanë rregullat e tyre të punës dhe fushë veprimtarinë e ushtrojnë në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Këshilli ka këto komisione të përhershme:

KOMISIONI PËR ÇËSHTJE NORMATIVE

KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS GJYQËSORE

KOMISIONI PËR ADMINISTRIMIN E GJYKATAVE

KOMISIONI PËR BUXHET, FINANCA DHE PERSONEL

KOMISIONI PËR TRAJNIME

Po ashtu, në kuadër të KGJK-së funksionojnë:

KOMISIONI PËR KOMPENSIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR OSE TË ARRESTUAR PA ARSYE

ASAMBLEJA E KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQTARËVE MBIKËQYRËS

KOMITETI KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

4.1 Komisioni për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative (KÇN) është përgjegjës për inicimin, përgatitjen dhe hartimin e të gjitha akteve nënligjore dhe politikave të nevojshme për funksionimin e sistemit gjyqësor.

KÇN, ka mbajtur 89 takime, në të cilat kanë marrë pjesë partnerë vendor dhe ndërkombëtarë, me ç'rast ka rekomanduar për miratim në Këshill gjithsejtë 28 akte normative, si në vijim:

- 17 rregullore, prej të cilave 4 rregullore janë për ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve bazë;
- 6 udhëzime administrative;
- 2 katalogje të pozitive dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit në njësitë e Këshillit;
- Kodin e Etikes për Përkthyes dhe Interpret Gjyqësor;
- Doracakun për punën e përkthyesve dhe interpretëve në sistemin gjyqësor të Kosovës;
- Planin Strategjik të Teknologjisë Informative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2024 - 2029.

Nga këto akte të miratuara, 5 prej tyre kanë qenë të parapara si masa legjislativë për Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, duke mundësuar implementimin e të gjitha masave legjislativë të planifikuara për PKZMSA brenda një viti.

Komisioni, po ashtu ka finalizuar dhe rekomanduar për miratim në Këshill, 9 akte normative përtej Planit të Punës për vitin 2023, dhe atë: 4 rregullore, prej të cilave 1 rregullore është për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores bazë dhe 5 udhëzime administrative.



Rregulloret e rekomanduara prej KÇN-së dhe të miratuara nga KGJK janë:

- Rregullore Nr. 01/2023 për Procedurën e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Drejtorit të Njesisë për Inspektim Gjyqësor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Rregullore Nr. 02/2023 për Qasje në Dokumente Publike;
- Rregullore Nr. 03/2023 për Normën e Punës së Gjyqtarëve;
- Rregullore Nr. 04/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve;
- Rregullore Nr. 05/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2021 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve;
- Rregullore Nr. 06/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjen dhe Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave;
- Rregullore Nr. 07/2023 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet, Shpërblimin dhe Disiplinimin e Përkthyesve dhe Interpretëve Gjyqësorë;
- Rregullore Nr. 08/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 11/2022 për Evidencën Penale në Republikën e Kosovës;
- Rregullore Nr. 09/2023 për Menaxhimin, Ruajtjen dhe Tjetërsimin e Pasurisë jo Financiare në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykata;
- Rregullore Nr. 10/2023 për Njësine Ligjore të Gjykatës Komerciale;
- Rregullore Nr. 11/2023 për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL);
- Rregullore Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht;
- Rregullore Nr. 13/2023 për Sistemin për Menaxhimin e Dosjes Elektronike të Gjyqtarëve;
- Rregullore Nr. 14/2023 për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin e Dosjes Elektronike të Administratës Gjyqësore;
- Rregullore Nr. 15/2023 për Statusin, Kushtet dhe Procedurën e Emërimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa;
- Rregullore Nr. 16/2023 për Trajnimin e Gjyqtarëve;
- Rregullore Nr. 17/2023 për Planifikimin e Trajnimeve për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.



Komisioni ka rekomanduar 6 udhëzime administrative të cilat janë miratuar nga Këshilli:


- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2023 për Procedurën për Kompensimin e Dëmit të Personave të Dënuar ose të Arrestuar pa Arsyë;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit në Sistemin Gjyqësor;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2023 për Instalimin dhe Përdorimin e Kamerave të Sigurimit dhe Ruajtjen e Video Regjistrimeve në Gjykatat e Republikës së Kosovës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2023 për Procedurat e Përdorimit dhe Menaxhimit të Parave të Imëta për Gjykata dhe Njësitë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2023 për Pranimin dhe Menaxhimin e të Hyrave dhe Depozitave Gjyqësore;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2023 për Procedurat për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike.

KÇN, ka rekomanduar akte të tjera normative të cilat janë miratuar nga Këshilli dhe atë:

- Plani Strategjik i Teknologjisë Informativë i Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2024 – 2029;
- Katalogu i Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Katalogu i Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Njësisë për Inspektim Gjyqësor;
- Kodi i Etikës për Përkthyes dhe/apo Përkthyes dhe Interpret Gjyqësor të Certifikuar dhe Emëruar;
- Doracaku për Punën e Përkthyesve dhe Interpretëve në Sistemin Gjyqësor të Kosovës.

Implementimi i Planit të Punës së Komisionit për Çështje Normative

Nga gjithsej 24 aktivitete të planifikuara, prej tyre ka përmbushur 117%, duke realizuar edhe aktivitete jashtë planit.



4.2. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve

Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve ka kompetencë të bëjë vlerësimin e performancës së gjyqtarëve me mandat të përhershëm sipas metodës 'Random', gjyqtarëve me mandat fillestarë dhe gjyqtarëve kandidatë për avancim.

Komisioni ka mbajtur 8 seanca plenare, në të cilat janë aprovuar gjithsejtë 161 raporte të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve, si dhe ka shqyrtuar dhe vendosur edhe për 25 kundërshtime ndaj raporteve të vlerësimit.

Komisioni ka përfunduar vlerësimin për këto kategori të gjyqtarëve:


- 2 gjyqtarë për ngritje në detyrë për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- 1 gjyqtar me mandat të përhershëm në Gjykatën Themelore, për ngritje në detyrë për pozitën e gjyqtarit në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore Prishtinë;
- 2 gjyqtarë pas përfundimit të mandatit si anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Performancës së Gjyqtarëve;
- 89 gjyqtarë me mandat të përhershëm të përzgjedhur sipas metodës Random për vitin 2023, për periudhën e vlerësimit 2020 - 2022;
- 22 gjyqtarë para përfundimit të mandatit fillestar me qëllim të ri-emërimit me mandat të përhershëm për periudhën e vlerësimit 2021 - 2023;
- 45 gjyqtarë pas përfundimit të trajnimit fillestar 12 mujor në Akademinë e Drejtësisë.

Në tabelën e mëposhtme, janë të pasqyruara të dhënat për shkallët e arritura të vlerësimit:

Proceset	Nr. gjyqtarëve të vlerësuar	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Ngritje në detyrë	3					3
Pas përfundimit të mandatit si anëtarë të KVPJGJ	2					2
Random 2020-2022	89			1	48	40
Ri-emërim	22				14	8
Trajnimi fillestar	45			18	27	
Totali	161			19	89	53

Implementimi i Planit të Punës së Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve

Nga gjithsej 9 aktivitete të planifikuara, prej tyre ka përmbytur 100%.



Aktivitete të implementuara
9

4.3 Komisioni për Administrimin e Gjykatave

Komisioni për Administrimin e Gjykatave (KAGJ), është përgjegjës për përgatitjen dhe rekomandimin e politikave për administrim të gjykatës, përfshirë atë të menaxhimit të rrjedhës së lëndëve, teknologjisë informative të menaxhimit të lëndëve, objekteve, qasjes së publikut, logjistikës dhe sigurisë.

Komisioni ka mbajtur 28 takime, me ç'rast ka trajtuar zhvillimin, unifikimin, arritjet, sfidat dhe ngeçjet në funksionimin e gjykatave, të cilat kanë kontribuar në përmirësimin e praktikave gjyqësore.

Po ashtu, së bashku me Njësinë për Inspektim Gjyqësor, ka bërë vizita në gjykatat e vendit, të cilat janë mbështetur edhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Komisioni, duke u bazuar në kompetencat e tij, ka mbështetur përgatitjen e akteve si në vijim:

- Draft Strategjinë e Teknologjisë Informative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2024–2029;
- Draft Planin Strategjik për ekzekutime;
- Draft Rregulloren për Certifikimin e Përkthyesve dhe Interpretëve Gjyqësorë;
- Draft Rregulloren për Procedurën Disiplinore të të punësuarve në Administratën Gjyqësore;
- Draft Rregulloren për përdorimin e SMIL;
- Draft Udhëzimin Administrativ për Instalimin dhe Përdorimin e Kamerave të Sigurimit dhe Ruajtjen e Video Regjistrimeve në Gjykatat e Kosovës;
- Draft Udhëzimin Administrativ për pranimin dhe menaxhimin e të hyrave dhe depozitave gjyqësore;
- Draft Udhëzimin Administrativ për procedurat e përdorimit dhe menaxhimit të parave të imëta për Gjykata dhe Njësitë;
- Draftin e Kodit të Etikës për Përkthyes dhe/apo Përkthyes dhe Interpret Gjyqësor të Certifikuar dhe Emëruar;
- Draftin e Doracakut për punën e përkthyesve dhe interpretëve në sistemin gjyqësor të Kosovës;
- Draftin e Udhërrëfyesit për matjen e kënaqshmërisë për shfrytëzimin e shërbimeve gjyqësore bazuar në metodologjinë e CEPEJ-it.



Po ashtu, Komisioni ka udhëhequr procesin e certifikimit të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë.

Komisioni ka përgatitur këto raporte, së bashku me të gjeturat dhe rekomandimet:


- Raportin për asgjësimin e lëndëve;
- Raportin së bashku me të gjeturat dhe rekomandime për krijimin e data bazës për vendimet e nxjerra nga KGJK, në vitet 2020, 2021 dhe 2022;
- Raportin mbi vlerësimin e shpërndarjes së lëndëve tek gjyqtarët;
- Raportin së bashku me të gjeturat dhe rekomandimet për shkak të parashkrimit të lëndëve;
- Raportin mbi procedurën disiplinore të administratës gjyqësore;
- Raportin e lëvizjes së lëndëve në aspektin kohor në kompetencë lëndore, në shkallën e dytë dhe të tretë;
- Raportin për vijueshmërinë në punë nga stafi i gjykatave, së bashku me të gjeturat dhe rekomandimet.

KAGJ ka përgatitur dokumente, të cilat përfshijnë formularët dhe shtojcat, për unifikimin dhe thjeshtimin e procedurave të raportimit për kryetarët e gjykatave, administratorët dhe grupet e punës, të cilat janë si në vijim:

- Shtojcën për formën e raportimit për kryetarët e gjykatave (Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Gjykata Komerciale dhe gjykatat themelore);
- Shtojcën për formën e raportimit të administratorëve të gjykatave (Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Gjykata Komerciale dhe gjykatat themelore);
- Shtojcën për formën e raportimit për grupet e punës.

Implementimi i Planit të Punës së Komisionit për Administrimin e Gjykatave

Nga gjithsej 20 aktivitete të planifikuara, prej tyre ka përmbyshur 95%.



4.4 Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel

Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, përgatitë dhe rekomandon politikat për zhvillim, rishikim dhe menaxhimin e buxhetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni ka shqyrtuar:

- Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026;
- Kërkesën buxhetore për vitin 2024 bazuar në Qarkoren Buxhetore të MFPT - 2024/1;
- Kërkesën buxhetore për vitin 2024 bazuar në Qarkoren Buxhetore të MFPT - 2024/2.

Po ashtu, Komisioni ka dorëzuar me shkrim të gjitha kërkesat buxhetore të KGJK-së për vitin 2024 dhe kërkesat për buxhet shtesë, në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit.

Aktivitetet tjera:

- Pjesëmarrja në grupet punuese në komisionet e përhershme të KGJK-së;
- Pjesëmarrja në dëgjimet e rregullta buxhetore për vitin 2024;
- Pjesëmarrja në grupet punuese për hartimin e akteve nënligjore;
- Paraqitje publike lidhur me buxhetin dhe sfidat e KGJK-së për buxhet.

Implementimi i Planit të Punës së Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel

Nga gjithsej 5 aktivitete të planifikuara, prej tyre ka përmbytur 100%.



Aktivitete të implementuara
5

4.5 Komisioni për Trajnime

Komisioni për Trajnime është përgjegjës të hartoj dokumente për politikat, standardet dhe udhëzimet për rregullimin e trajnimit të gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe stafit administrativ për trajnimin fillestar, trajnimin e vazhdueshëm, trajnimin e vazhdueshëm obligativ si dhe aktivitetet trajnuese tjera. Po ashtu, përgatit rekomandime dhe propozime relevante lidhur me trajnimin dhe aktivitet tjera trajnuese, për të gjithë kategoritë e të punësuarve në sistemin gjyqësor.

Komisioni ka hartuar këto raporte:

- Raportin për vlerësimin e nevojave trajnuese për gjyqtarët në Departmentin Special të Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Raportin për vlerësimin e nevojave trajnuese për të punësuarit në administratën e sistemit gjyqësor;
- Raportin analitik për rishikimin e standardeve, rregullave dhe politikave të trajnimit të gjyqtarëve.

Komisioni pas analizimit të situatës së trajnimeve për gjyqtarë, ka rekomanduar Akademinë e Drejtësisë, që të ri-dizajnohet programi i trajnimeve të vazhdueshme, si për nga përmbajtja, ashtu edhe për nga mënyra e zbatimit të programit.


Po ashtu, Komisioni ka përcaktuar edhe standardet, rregullat, përmbajtja dhe parimet e trajnimit fillestar për gjyqtarët porotë. Trajnimi teorik për gjyqtarët porotë është zhvilluar në Akademinë e Drejtësisë, ndërsa trajnimi praktik është zhvilluar nga gjykatat themelore.

Gjithashtu, Komisioni ka hartuar Draft Rregulloren për Trajnime të Gjyqtarëve dhe Draft Rregulloren për Trajnimin e të Punësuarve në Administratën e sistemit gjyqësor, e cila paraqet bazën më të rëndësishme të zhvillimit dhe avancimit profesional të të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor.



Implementimi i Planit të Punës së Komisionit për Trajnime

Nga gjithsej 10 aktivitete të planifikuara, prej tyre ka përbushur 84%.



5. Komisioni për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose Arrestuar pa arsye

Departamenti për Çështje Ligjore ka përgatitur së bashku me Komisionin, të gjitha dosjet lidhur me kërkesat e palëve sa i përket Kompensimit të Dëmit për persona të dënuar ose arrestuar pa arsye.

Në linkun e mëposhtëm, gjeni raportin e detajuar lidhur me kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa arsye:



RAPORTI MBI PUNËN E KOMISIONIT PËR KOMPENZIM DËMI PËR
PERSONAT E DËNUAR OSE ARRESTUAR PA ARSYE 2023

SHIKO RAPORTIN PËR VITIN 2023



6. ASAMBLEJA E KRYETARËVE TË GJYKATAVE DHE GJYQATARËVE MBIKËQYRËS

Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës ka rol këshillëdhënës për KGJK-në dhe funksionon konfor rregulloreve në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Asamblesë.

Gjatë këtij viti, është zgjedhur Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi i Asamblesë.

Asambleja ka mbajtur 4 takime nga të cilat janë nxjerr rekomandimet për:

- Çështjen e sigurisë në gjykata, fillimi i implementimit të projektit 'Funksionalizimi i Qendrave për Monitorimin e kamerave', në objektet e gjykatave themelore;
- Hartimin e Udhëzuesit për caktimin e normës së bashkëpunëtorëve profesional;
- Hartimin e planit të veprimit për Inspektim të përgjithshëm të mënyrës së funksionimit të administratës gjyqësore;
- Zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-118, të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës janë informuar lidhur me praktikën që duhet të ndjekin gjykatat për çështjet që janë pranuar para dhe pas hyrjes në fuqi të ligjit të cekur si më lartë;
- Përfshirjen në Planin Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025, trajtimi i lëndëve të të pandehurve që kanë më shumë se dy aktakuza të ngritura;
- Udhëzuesin për regjistrimin e seancave gjyqësore;
- Publikimin e shkaqeve të dështimit të seancave gjyqësore;
- Hartimin e aktitit rreth mënyrës së veprimit për dërgimin e aktgjykimeve tek punëdhënësit, në rastet kur në aktgjykime përfshihen edhe dënimet plotësuese;
- Caktimin e rasteve kur mund të konsiderohet se kërkesat janë të përfunduara për lëndët e fushës së përmbarimeve, ku gjykatat janë propozues për përmbarim dhe sa i përket paushalleve gjyqësore;
- Ri-funksionalizimin e Shoqatës së Gjyqtarëve.

Gjithashtu, Asambleja ka miratuar edhe Planet e Veprimit të Drejtësisë Procedurale për gjykatat themelore dhe degët e tyre.



7. KOMITETI KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore është përgjegjës t'i ndihmoj gjyqtarët me informacione dhe këshilla rreth pyetjeve, apo çështjeve etike të identifikuara për interpretim në lidhje me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë dhe Ligjit të Procedurës Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Komiteti shërben si platformë ku gjyqtarët mund të këshillohen si t'i trajtojnë situatat, apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Opinionet e Komitetit jepen lidhur me situatat, apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë, për dallim nga procesi disiplinor ku përfshihen hetimet dhe seancat e mundshme që shqyrtojnë dhe zgjidhin ankesa për sjelljet e pretenduara jo etike të gjyqtarëve në të kaluarën.

Komiteti përbëhet prej 5 anëtarëve, me mandat 3 vjeçar me mundësi rizgjedhje.

Komiteti nga fillimi i punës ka nxjerr gjithsej 5 opinione, si:


- Për standardet etike të zbatueshme, në rastin e barazisë së palëve, trajtimit të lëndëve gjyqësore sipas prioritetit dhe radhës së regjistrimit të tyre në gjykatë;
- Lidhur me kërkesën e Zyrës për Vlerësimin dhe Verifikimin Gjyqësor me të cilën është hedhur si e pa lejuar kërkesa për dhënie të opinionit për çështje lëndore;
- Për standardet etike të zbatueshme, në rastin e komunikimit të gjyqtarit me media dhe me monitoruesit e sistemit të drejtësisë dhe mbrojtjes së integritetit të procedurës gjyqësore gjatë trajtimit të një rasti konkret;
- Lidhur me trajtimin e rasteve të përfshira në kërkesën e Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Për standardet etike të zbatueshme lidhur me organizimin e punës së gjyqtarëve me qëllim të shfrytëzimit të plotë dhe efikas të orarit të punës.



8. PANELI PËR LIRIM ME KUSHT

Paneli për Lirim me Kusht është kompetent për shqyrtimin e të gjitha kërkesave dhe propozimeve për lirim me kusht, në bazë të raporteve të përpiluara nga ekipet profesionale të institucioneve korrektuese të Kosovës.

Nga viti 2022 ka bartur 110 kërkesa, ndërsa gjatë vitit 2023, paneli ka pranuar 762 kërkesa të reja, duke e arritur totalin në 872 kërkesa për shqyrtim. Janë organizuar 55 seanca, me ç'rast janë shqyrtuar 816 kërkesa për lirim me kusht, për të cilat paneli ka vendosur si në vijim:



Nga totali i 816 kërkesave, 8 vijnë nga Qendra Korrektuese për Femra dhe 12 nga Qendra Korrektuese për të Mitur.

Paneli ka analizuar 840 raporte informative nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, të cilat kanë ofruar një pasqyrë të detajuar mbi sjelljen dhe përmbushjen e kushteve nga individët e liruar me kusht. Po ashtu, janë shqyrtuar edhe 35 kërkesa për udhëtim jashtë vendit të parashtruara nga të liruarit me kusht. Në lidhje me mos përmbushjen e obligimeve nga të liruarit me kusht, Paneli ka marrë masën e revokimit të 16 aktvendimeve të mëparshme.

Me qëllim të rritjes së transparencës së punës së Panelit, janë publikuar 900 aktvendime në faqen zyrtare të KGJK-së, përkatësisht 418 aktvendime më shumë, se në vitin paraprak.

Paneli ka vazhduar bashkëpunimin me Institucionin e Avokatit të Popullit, Misionin e EULEX-it dhe OJQ-të, të cilat kanë monitoruar proceset e lirimit me kusht.

9. PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor sipas legjislacionit në fuqi.

Këshilli emëron kryesuesin e PZAP-it, nga radha e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, ndërsa anëtarët emërohen nga radha e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, me mandat 4 vjeçar konfor Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në linkun e mëposhtëm, gjeni raportin e detajuar lidhur me veprimtarinë dhe aktivitetet e PZAP:

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

RAPORT

PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNAVE NË
MITROVICËN E VERIUT, ZUBIN POTOK, LEPOSAVIQ, ZVEÇAN DHE PËR ZGJEDHJET E
PARAKOHSHME PËR KUVENDET E KOMUNAVE LEPOSAVIQ DHE ZVEÇAN

SHIKO RAPORTIN PËR VITIN 2023



PJESA E TRETË

10. VEPRIMTARIA E GJYKATAVE

Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat e themeluara me Ligjin për Gjykatat i cili është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik, i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata. Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe parimet e njohura ndërkombëtarisht për barazi gjinore.

Sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Gjykata Komerciale dhe gjykatat themelore.

Gjykata Supreme është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, ku përfshin kolegjin e apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e së cilës janë pjesë e Gjykatës Supreme.

Gjykata e Apelit vepron si gjykatë e shkallës së dytë me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës.

Gjykata Komerciale ka kompetencë për të gjitha kontestet tregtare, konfliktet administrative dhe ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës siç përcaktohet me Ligjin për Gjykatën Komerciale.

Republika e Kosovës ka 7 gjykata themelore të cilat janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet në territorin e Republikës së Kosovës, si në vijim:

 GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

 GJYKATA THEMELORE GJILAN

 GJYKATA THEMELORE PRIZREN

 GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

 GJYKATA THEMELORE PEJË

 GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

 GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Degët e gjykatave themelohen brenda territorit të një Gjykate Themelore.

10.1 Gjykata Supreme

Gjykata Supreme është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka kompetencë të vendosë lidhur me kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës, vendos në shkallë të tretë për ankesat e lejuara me ligj, përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës.

Po ashtu, Gjykata Supreme ka kompetencë për të vendosur për lëndët e Agjencisë Kosovare të Pronave, në Dhomën e Posaçme, lëndët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, siç parashihet me ligj.

Gjykata Supreme ka mbajtur 3 seanca të përgjithshme dhe ka miratuar:

- 5 mendime juridike;
- 1 qëndrim parimor;
- 3 udhëzues;
- 1 doracak për seancën për matjen e dënimit;
- 2 përmbledhje të Gjykatës Supreme të Kosovës me vendime të përzgjedhura.

Komisioni Këshillëdhënës për Politikë Ndëshkimore i kryesuar nga Gjykata Supreme, ka punuar në revidimin e Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore, me qëllim të harmonizimit me ndryshimet e Kodit Penal dhe atij të Procedurës Penale, si dhe me qëllim të lehtësimit të zbatimit të tij në praktikë.

Kryetari i Gjykatës Supreme, si autoritet kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave ndaj kryetarëve të gjykatave themelore dhe asaj të Apelit, bazuar në Ligjin për Përgjegjësisë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka pranuar dhe shqyrtuar; 27 ankesa. Vendimet lidhur me ankesat e shqyrtuara janë të publikuara në ueb faqen e gjykatës.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Media në Gjykatë Supreme ka pranuar: 58 kërkesa për qasje në dokumente publike, prej tyre, 52 kërkesa janë aprovuar, ndërsa 6 kërkesa të tjera janë refuzuar konfor Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.



Gjykata Supreme, gjatë vitit 2023 ka pranuar 1.860 lëndë të reja, ndërsa ka trashëguar nga vitit paraprak 202 lëndë. Gjatë periudhës raportuese ka kryer 1.848 lëndë, derisa të pakryera kanë mbetur vetëm 214 lëndë. Nga kjo rezulton se shkalla e efikasitetit e kalkuluar në përqindje është 99.35%.


Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka pranuar 1.971 lëndë të reja, ndërsa ka trashëguar nga vitit paraprak 14.517 lëndë. Gjatë periudhës raportuese ka kryer 3.193 lëndë, derisa të pakryera kanë mbetur 13.295 lëndë. Nga kjo rezulton se shkalla e efikasitetit e kalkuluar në përqindje është 162.00 %.

Në ueb faqen e Gjykatës Supreme janë publikuar 2.989 vendime, prej tyre 1.140 vendime të Gjykatës Supreme dhe 1.849 vendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Sfida kryesore gjatë vitit 2023 ka qenë mungesa e përkthyesve shqip-serbisht dhe anasjelltas, pasi vendimet përkthehen vetëm nga një përkthyes. Si rrjedhim, shkaktohen vonesa në ekspedimin e lëndëve.

Implementimi i Planit të Punës së Gjykatës Supreme

Nga gjithsej 19 aktivitete të planifikuara, prej tyre janë përmbushur 84%.



10.2 Gjykata e Apelit

Gjykata e Apelit vepron si gjykatë e shkallës së dytë, me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës me seli në Prishtinë. Kjo gjykatë është kompetente të shqyrtojë të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të gjykatave themelore, të vendos për konfliktin e juridiksionit ndërmjet gjykatave themelore dhe çështjet tjera të parapara me ligj.

Po ashtu, në kuadër të Gjykatës së Apelit vepron edhe Divizioni i Apelit në Mitrovicë.

Me qëllim të zvogëlimit të lëndëve të vjetra të pazgjidhura, gjykata ka hartuar Planin e Veprimit për zgjidhje efikase të lëndëve të vjetra dhe lëndëve të cilat janë në fokus të Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi. Po ashtu, Gjykata e Apelit në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë ka organizuar disa punëtori, lidhur me unifikimin e praktikës gjyqësore sa i përket çështjeve civile, administrative dhe penale, ku janë nxjerrë dhe publikuar 23 konkluzione nga lëmia civile dhe administrative dhe 13 konkluzione nga lëmia penale.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, si autoritet kompetent ka pranuar dhe shqyrtuar edhe ankesat ndaj gjyqtarëve bazuar në Ligjin për Përgjegjësisë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Vendimet lidhur me ankesat e shqyrtuara janë të publikuara në ueb faqen e gjykatës.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Media, në Gjykatë e Apelit ka pranuar dhe vendosur lidhur me 50 kërkesa për qasje në dokumente publike konfor Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Gjithashtu, janë dhënë edhe 508 përgjigje për persona fizik dhe juridik.

Gjykata gjatë periudhës raportuese ka pasur në punë 35.923 lëndë, ku të trashëguara nga viti paraprak kanë qenë 15.382 lëndë, ndërsa lëndë të reja janë pranuar 20.541. Nga të dhënat statistikore rezulton se në total, gjykata ka zgjidhur 18.577 lëndë apo 1.214 lëndë më shumë se në vitin paraprak.


Në ueb faqen e Gjykatës së Apelit janë publikuar 7.558 vendime.



Sfidat kryesore gjatë vitit 2023 të gjykatës kanë qenë përfundimi i lëndëve të vjetra (2018 – 2020), praktikat e ndryshme të vendosjes nga gjyqtarët e kësaj gjykate, dorëheqja e gjyqtarëve serb nga Divizioni i Mitrovicës, shpërndarja e lëndëve të tyre tek gjyqtarët e Gjykatës së Apelit (dhe përkthimi i tyre), lëvizjet e vazhdueshme të stafit të gjykatës (pensionimi i 5 gjyqtarëve dhe 3 referentëve), problemet me implementimin e plotë të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) si dhe aspektet e tjera teknike të cilat në një masë apo tjetër kanë pasur ndikim në punën e gjykatës duke ndikuar në shkallën e efikasitetit të saj.

Implementimi i Planit të Punës së Gjykatës së Apelit

Nga gjithsej 19 aktivitete të planifikuara, prej tyre janë përbushur 100%.



10.3 Gjykata Komerciale

Gjykata Komerciale e Kosovës, ka kompetencë për të gjithë kontestet tregtare dhe konfliktet administrative dhe ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me Ligjin për Gjykatën Komerciale.

Gjykata Komerciale procesin profesional të punës, gjatë vitit 2023 e ka kryer me 17 gjyqtarë, 6 gjyqtarë janë caktuar në Dhomat e Shkallës së Dytë, si dhe 11 gjyqtarë në Dhomat e Shkallës së Parë. Gjatë kësaj periudhe, 5 nga gjyqtarët e Shkallës së Parë pavarësisht emërimit të tyre, nuk kanë vepruar me kapacitetin e tyre të plotë, për shkak se kanë qenë gjyqtarë të rinj të cilët kanë ndjekur trajnimin fillestar dhe kanë qenë të angazhuar, vetëm pjesërisht dhe atë në lëndët përmbare.

Përveç numrit të vogël të gjyqtarëve të angazhuar, gjykata deri në fund të këtij viti raportues ka funksionuar me kapacitete të përgjysmuara, edhe në aspektin e plotësimit të të gjitha pozitave administrative të cilat parashihen me organogramin e Gjykatës Komerciale. Ndërsa, në fund të vitit gjykata ka pranuar 5 bashkëpunëtorë profesional dhe 12 zyrtarë ligjor.


Kryetari i Gjykatës Komerciale, si autoritet kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave ndaj gjyqtarëve, bazuar në Ligjin për Përgjegjësisë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka pranuar dhe shqyrtuar 8 ankesa. Vendimet lidhur me ankesat e shqyrtuara janë të publikuara në ueb faqen e gjykatës.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit, eliminimin e vonesave, ngritjen e kualitetit të shërbimeve gjyqësore në veçanti të vendimeve, Gjykata Komerciale gjatë muajit prill 2023, ka hartuar Planin e Veprimit për Reduktimin e Lëndëve për periudhën maj – dhjetor 2023, me ç'rast ishte planifikuar që gjykata të zgjidh rreth 5.000 lëndë, ndërsa nga të dhënat statistikore rezulton se në total, në të dy shkallët janë zgjidhur 6.239 lëndë. Gjykata Komerciale ka pasur në punë 15.478 lëndë në dy shkallët, ku të trashëguar nga viti paraprak kanë qenë 9006, ndërsa lëndë të reja të pranuar 6.472.

Në ueb faqen e Gjykatës Komerciale janë publikuar 4.467 vendime të Dhomës së Shkallës së Dytë dhe Shkallës së Parë.

Implementimi i Planit të Punës së Gjykatës Komerciale

Nga gjithsej 18 aktivitete të planifikuara, prej tyre janë përmbushur 94%.



10.4 Gjykata Themelore Prishtinë

Gjykata Themelore Prishtinë si gjykatë e shkallës së parë ka 5 degë dhe atë:

- Dega në Podujevë për komunën e Podujevës;
- Dega në Graçanicë për komunën e Graçanicës;
- Dega në Lipjan për komunën e Lipjanit;
- Dega në Glllogovc për komunën e Glllogovcit;
- Dega në Fushë Kosovë për komunën e Fushë Kosovës dhe komunën e Obiliqit.

Gjykata Themelore Prishtinë, me ndihmën e projektit CLARD dhe IKD ka zhvilluar aktivitetin e 'Ditëve të Hapura të Gjykatës', me ç'rast janë zhvilluar takime me qytetarë. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe gjykata ka pasur bashkëpunim me institucione, veprimtaria e të cilave mund të ketë ndikim në aspektin e efikasitetit apo të ngritjes së besueshmërisë së opinionit publik në përgjithësi në gjykatë, si Policia e Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Prokurorisë Themelore, Prokurorisë Speciale, Komuna e Prishtinës, etj.

Kryetarja e gjykatës si autoritet kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave ndaj gjyqtarëve, bazuar në Ligjin për Përgjegjësisë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka pranuar dhe shqyrtuar 19 ankesa. Po ashtu, ka iniciuar 2 hetime preliminare sipas detyrës zyrtare. Vendimet lidhur me ankesat e shqyrtuara janë të publikuara në ueb faqen e gjykatës.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Media, në këtë gjykatë ka vendosur për 118 kërkesa për qasje në dokumente publike, konfor Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Po ashtu, ka dhënë 932 përgjigje dhe informacione për gazetarë dhe OJQ.

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë veprojnë dy departamente me kompetencë ekskluzive për tërë territorin e Republikës së Kosovës, si:

- Departamentin Special ka pasur në punë 185 lëndë dhe ka arritur të përfundoj 60 lëndë;
- Departamenti Administrativ ka pasur në punë 7.571 lëndë dhe ka arritur të përfundoj 2557 lëndë.



Gjykata ka pasur në punë 129.686 lëndë, duke përfshirë degët, ku të trashëguara nga viti paraprak kanë qenë 85.315 lëndë, ndërsa lëndë të reja janë pranuar 44.371. Nga të statistikore rezulton se në total, gjykata ka zgjidhur 37.247 lëndë.

Po ashtu, gjykata ka përfunduar edhe:

- 141 kërkesa të autoriteteve të shteteve të ndryshme për ndihmë juridike ndërkombëtare;
- 302 kërkesa për përjashtim të gjyqtarëve;
- 121 kërkesa për lirim të parakohshëm me kolegjin penal.

Zyra për ekzekutimin e lëndëve në gjykatë ka:

- Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale ka pasur në punë në total 4.357 dhe janë ekzekutuar 2.571 lëndë;
- Zyra për ekzekutimin e lëndëve në lëmin civile ka pasur në punë në total 2.021 dhe janë ekzekutuar 1.870 lëndë;
- Divizioni për kundërvajtje ka pasur në punë në total 3.481 dhe janë ekzekutuar 2.038 lëndë.


Zyra e ndërmjetësimit ka pasur në punë gjithsej 864 lëndë gjyqësore, prej të cilave 287 lëndë në lëmin penale dhe 577 lëndë në lëmin civile dhe në total janë përfunduar me marrëveshje për ndërmjetësim 397.

Në ueb faqen e gjykatës janë publikuar 3807 vendime gjyqësore, duke përfshirë degët e gjykatës.

Gjykata është ballafaquar me numër të madh të lëndëve të reja posaçërisht në lëmin civile dhe administrative, mungesa e gjyqtarëve ku ka vështirësuar edhe krijimin e trupeve gjyqësore në departamentet përkatëse. Sfidat më të mëdha të gjykatës ngelet numri i madh i lëndëve të vjetra që presin për shqyrtim të grumbulluara ndër vite e që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ecurinë e procesit të administrimit të shpejtë dhe efikas të drejtësisë.

Implementimi i Planit të Punës së Gjykatës Themelore Prishtinë

Nga gjithsej 22 aktivitete të planifikuara, prej tyre janë përmbushur 91%.



10.4 Gjykata Themelore Gjilan

Gjykata Themelore në Gjilan si gjykatë e shkallës së parë ka 3 degë dhe atë:

- Dega në Kamenicë, për komunën e Kamenicës dhe komunën e Ranillugut;
- Dega në Viti, për komunën e Vitisë dhe komunën e Klllokotit;
- Dega Novobërdës për komunën e Novobërdës.

Kryetari i gjykatës si autoritet kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave ndaj gjyqtarëve ka nxjerrë 8 vendime disiplinore. Vendimet lidhur me ankesat e shqyrtuara janë të publikuara në ueb faqen e gjykatës.

Në këtë gjykatë ka filluar implementimi i projektit për audio dhe video incizime në një sallë të gjykatës, ndërsa në 9 salla të tjera janë të instaluar pajisjet e audios. Gjithashtu, në bashkëpunim me partnerët Justice Activity – USAID është duke implementuar projektet dhe aktivitetet për përmirësimin e qasjes në drejtësi.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Media, në këtë gjykatë ka pranuar 11 kërkesa për qasje në dokumente publike, prej tyre 10 kërkesa janë aprovuar, ndërsa 1 kërkesë është refuzuar konfor Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Po ashtu, janë dhënë 55 përgjigje dhe informacione për gazetarë, OJQ dhe janë publikuar 31 komunikata.


Gjykata ka pasur në punë 33.435 lëndë, duke përfshirë degët, ku të trashëguara nga viti paraprak kanë qenë 19.022 lëndë të gjitha natyrave, ndërsa lëndë të reja janë pranuar 14.413. Nga të statistikore rezulton se në total, gjykata ka zgjidhur 15.496 lëndë.

Në ueb faqen e gjykatës janë publikuar 4.817 vendime gjyqësore, duke përfshirë degët e gjykatës.

Sa i përket sfidave, gjykata është ballafaquar me numër të madh të lëndëve të reja posaçërisht në lëmin civile, mungesë të stafit profesional dhe administrativ.

Implementimi i Planit të Punës së Gjykatës Themelore Gjilan

Nga gjithsej 22 aktivitete të planifikuara, prej tyre janë përmbushur 95%.



10.6 Gjykata Themelore Prizren

Gjykata Themelore në Prizren si gjykatë e shkallës së parë ka 2 degë dhe atë:

- Dega në Dragash për komunën e Dragashit;
- Dega në Suharekës për komunën e Suharekës.

Gjykata nga janari i vitit 2023, ka riorganizuar funksionimin e hapsirave në dy objekte, pasi që divizioni civil, përkatësisht gjyqtarët dhe stafi janë bartur në objektin përcjellës. Gjithashtu, në këtë gjykatë ka filluar implementimi i projektit për audio dhe video incizime në 4 salla të gjykatës, si dhe në bashkëpunim me partnerët Justice Activity – USAID është duke implemtuar projektet dhe aktivitetet për përmirësimin e qasjes në drejtësi, ku përfshihen rreth 15 aktivitete që duhet zbatuar në disa faza, dhe tani rreth 12 aktivitete janë zbatuar dhe 3 të tjera do implementohen në vazhdim.

Gjykata ka përmbushur mbi 90% të obligimeve dhe aktiviteteve që dalin nga plani i punës së KGJK-së dhe që janë aktivitetet e gjykatës.

Kryetarja e gjykatës si autoritet kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave ndaj gjyqtarëve, ka trajtuar 19 raste disiplinore. Në 18 raste ka marrë vendim për refuzim të ankesave, kurse 1 rast sipas detyrës zyrtare ka iniciuar procedurë disiplinore. Të gjitha vendimet lidhur me ankesat e shqyrtuara janë të publikuara në ueb faqen e gjykatës.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Media, në këtë gjykatë ka vendosur për 29 kërkesa për qasje në dokumente publike, ku 26 prej tyre janë aprovuar, ndërsa 2 kërkesa janë refuzuar, konfor Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Po ashtu, ka dhënë 133 përgjigje dhe informacione për gazetarë dhe OJQ. Gjithashtu, gjykata ka publikuar 68 komunikata për media për caktim të masës së sigurisë apo shpallje të vendimeve gjyqësore.


Gjykata ka pasur në punë 40.650 lëndë, duke përfshirë degët, ku të trashëguara nga viti paraprak kanë qenë 24.068 lëndë, ndërsa lëndë të reja janë pranuar 16.582. Nga të statistikore rezulton se në total, gjykata ka zgjidhur 16.585.

Në ueb faqen e gjykatës janë publikuar 4.624 vendime gjyqësore, duke përfshirë degët e gjykatës.

Sa i përket sfidave për gjykatën rezulton se ka mungesë të stafit profesional dhe administrativ.

Implementimi i Planit të Punës së Gjykatës Themelore Prizren

Nga gjithsej 22 aktivitete të planifikuara, prej tyre janë përmbushur 100%.



Aktivitete të implementuara

22

10.7 Gjykata Themelore Gjakovë

Gjykata Themelore në Gjakovë si gjykatë e shkallës së parë ka 2 degë dhe atë:

- Dega në Malishevë për komunën e Malishevës;
- Dega në Rahovec për komunën e Rahovecit.

Gjykata me mbështetjen e USAID, në kuadër të projektit "Drejtësia Procedurale", ka zhvilluar aktivitetin e 'Ditëve të Hapura të Gjykatës', me ç'rast janë zhvilluar takime me qytetarë.

Kryetari i gjykatës si autoritet kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave ndaj gjyqtarëve, ka trajtuar 3 raste disiplinore, ku vendimet lidhur me ankesat e shqyrtuara janë të publikuara në ueb faqen e gjykatës.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Media, në këtë gjykatë ka pranuar 31 kërkesa për qasje në dokumente publike, prej tyre, 27 janë aprovuar, 2 kërkesa i ka refuzuar pjesërisht dhe 2 të tjera janë refuzuara në tërësi, si dhe ka publikuar 27 komunikata. Po ashtu, gjykata ka adresuar në Komisionin e Pavarur të Mediave 2 ankesa lidhur me shkrimet ndaj Gjykatës Themelore Gjakovë, të cilat janë aprovuar.

Gjykata ka pasur në punë 25.754 lëndë, duke përfshirë degët, ku të trashëguara nga viti paraprak kanë qenë 15.971 lëndë, ndërsa lëndë të reja janë pranuar 9.783. Nga të dhënat statistikore rezulton se në total, gjykata ka zgjidhur 9.540 lëndë, ndërsa ka përfunduar 47 lëndë të ndihmës juridike.


Në ueb faqen e gjykatës janë publikuar 4.869 vendime gjyqësore, duke përfshirë degët e gjykatës, përkatësisht 1.504 vendime më shumë se në vitin paraprak.

Gjykata ka mbajtur 4 mbledhje të kolegjiut në të cilat janë diskutuar edhe sfidat me të cilat ballafaqohet gjykata me degët e saj.

Sfidë gjatë vitit raportues për këtë gjykatë ka qenë numri i vogël i gjyqtarëve, posaçërisht në divizionin civil, ku nga gjysma e vitit ka funksionuar vetëm me 3 gjyqtarë. Sfidë mbetet edhe formimi i trupave gjykues në Departamentin e Krimeve të Rënda, pasi që edhe ky departament funksionon me 3 gjyqtarë. Mungesa e stafit administrativ të gjykatës mbetet një tjetër sfidë veçanërisht mungesa e referentëve

Implementimi i Planit të Punës së Gjykatës Themelore Gjakovë

Nga gjithsej 22 aktivitete të planifikuara, prej tyre janë përmbushur 95%.



10.8 Gjykata Themelore Pejë

Gjykata Themelore në Pejë si gjykatë e shkallës së parë aktualisht funksionon me 3 degë dhe atë:

- Dega në Istog për komunën e Istogut;
- Dega në Klinë për komunën e Klinës;
- Dega në Deçan për komunën e Deçanit.

Gjykata në bashkëpunim me partnerët Justice Activity – USAID është duke implementuar projektet dhe aktivitetet për përmirësimin e qasjes në drejtësi dhe gjatë vitit 2023, objekti i gjykatës është pasuruar me inovacione, përfshirë këtu tablet për të shurdhër, shenjzimi për të verbër dhe parkingu për persona me aftësi të kufizuar.

Gjykata ka përmbushur mbi 90% të obligimeve dhe aktiviteteve që dalin nga plani i punës së KGJK-së.

Kryetari si autoritet kompetent, pas pranimit dhe shqyrtimit të ankesave ndaj gjyqtarëve, ka vendosur për 13 ankesa, prej të cilave, 12 janë refuzuar dhe 1 kërkesë është deleguar për vendosje në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës për shkak të ekzistimit të konfliktit të interesit. Autoriteti kompetent ka iniciuar 2 raste sipas detyrës zyrtare dhe në të 2 rastet i ka pushuar hetimet. Të gjitha vendimet lidhur me ankesat e shqyrtuara janë të publikuara në ueb faqen e gjykatës.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Media, në këtë gjykatë ka vendosur për 39 kërkesa për qasje në dokumente publike, ku 34 janë aprovuar plotësisht, 4 janë aprovuar pjesërisht, ndërsa 1 kërkesë është refuzuar, konfor Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.


Gjykata ka pasur në punë 37.763 lëndë, duke përfshirë degët, ku të trashëguara nga viti paraprak kanë qenë 20.542 lëndë, ndërsa lëndë të reja janë pranuar 16.521. Nga të dhënat statistikore rezulton se në total, gjykata ka zgjidhur 13.323. Sukses të veçantë gjykata ka treguar në fushën e ndërmjetësimit si procedurë alternative për zgjedhjen e kontesteve ashtu që ka zgjidhur në total 2.497 lëndë, prej të cilave 2.218 lëndë civile dhe 279 lëndë penale.

Në ueb faqen e gjykatës janë publikuar 1.977 vendime gjyqësore, duke përfshirë degët e gjykatës.

Sa i përket sfidave, gjykata është përballur me mungesë të stafit përkatësisht referentëve, arkivistit si dhe hapsirave për zyre, arkivë dhe sallat e gjykimit.

Implementimi i Planit të Punës së Gjykatës Themelore Pejë

Nga gjithsej 22 aktivitete të planifikuara, prej tyre janë përmbushur 95%.



10.9 Gjykata Themelore Ferizaj

Gjykata Themelore në Ferizaj si gjykatë e shkallës së parë aktualisht funksionon me 2 degë dhe atë:

- Dega në Kaçanik, për komunën Kaçanikut;
- Dega në Shtërpçë për komunën e Shtërpçës.

Gjykata ka filluar implementimi i projektit për audio dhe video incizime në të cilën, në një 1 sallë të gjykatës janë vendosur pajisjet me audio dhe video ingjizim, ndërsa në 7 salla të tjera me audio incizim si dhe në bashkëpunim me partnerët Justice Activity – USAID, është duke implemtuar projektet dhe aktivitetet për përmirësimin e qasjes në drejtësi, në të cilat raste gjykata ka ofruar bashkëpunim duke u mundësuar qasje në marrjen e shërbimeve në këtë institucion edhe personave me aftësi të kufizuar.

Kryetari si autoritet kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave ndaj gjyqtarëve, ka trajtuar 10 raste disiplinore, me ç'rast ka marrë vendim për refuzim të ankesave, ku të gjitha vendimet lidhur me ankesat e shqyrtuara janë të publikuara në ueb faqen e gjykatës.

Në këtë gjykatë janë pranuar 39 kërkesa për qasje në dokumente publike, për të cilat janë nxjerr 12 vendime dhe 27 përgjigje, konfor Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, dhe poashtu gjykata ka publikuar 61 komunikata.

Gjykata gjatë periudhës raportuese ka pasur në punë 38.314 lëndë, duke përfshirë degët, ku të trashëguara nga viti paraprak kanë qenë 24.288 lëndë, ndërsa lëndë të reja janë pranuar 14.026.


Nga të dhënat statistikore rezulton se në total, gjykata ka zgjidhur 12.920.

Në ueb faqen e gjykatës janë publikuar 3.009 vendime gjyqësore, duke përfshirë degët e gjykatës.

Sa i përket sfidave, gjykata është përballur me numër të madh të lëndëve të pranuar në lëminë civile, dhe gjithashtu me numër të vogël të stafit profesional dhe ai administrativ, përfshirë këtu gjyqtarë dhe zyrtarë.

Implementimi i Planit të Punës së Gjykatës Themelore Ferizaj

Nga gjithsej 22 aktivitete të planifikuara, prej tyre janë përmbushur 82%.



10.10 Gjykata Themelore Mitrovicë

Gjykata Themelore në Mitrovicë si gjykatë e shkallës së parë ka 3 degë dhe atë:

- Dega në Leposaviq për komunën e Leposaviq;
- Dega në Vushtrri për komunën e Vushtrrisë;
- Dega në Zubin Potok për komunën e Zubin Potok-ut;
- Dega në Skenderaj për komunën e Skenderajt.

Gjykata në bashkëpunim me partnerët Justice Activity – USAID është duke implemtuar projektet dhe aktivitetet për përmirësimin e qasjes në drejtësi dhe gjatë vitit 2023 objekti i Gjykatës Themelore në Mitrovicë është pasuruar me inovacione përfshirë këtu tablet për të shurdhër, shenjzimi për të verbër dhe parkingu për persona me aftësi të kufizuar.

Ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore Mitrovicë, si autoritet kompetent, ka pranuar gjithsej 11 ankesa disiplinore ndaj gjyqtarëve ndaj të cilave janë nxjerr 11 vendime. Të gjitha vendimet lidhur me ankesat e shqyrtuara janë të publikuara në ueb faqen e gjykatës.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Media, në këtë gjykatë ka vendosur për 39 kërkesa për qasje në dokumente publike, ku prej tyre, 34 janë aprovuar plotësisht, 4 janë aprovuar pjesërisht, ndërsa, 1 kërkesë është refuzuar, konfor Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Gjykata gjatë periudhës raportuese ka pasur në punë 34.693 lëndë, duke përfshirë degët, ku të trashëguara nga viti paraprak kanë qenë 22.367 lëndë, ndërsa lëndë të reja janë pranuar 12.326.


Nga të dhënat statistikore rezulton se në total, gjykata ka zgjidhur 12.021.

Në ueb faqen e gjykatës janë publikuar 8925 vendime gjyqësore, duke përfshirë degët e gjykatës.

Sa i përket sfidave, gjykata është përballur me mungesë të gjyqtarëve për shkak të dorëheqjeve dhe shkarkimeve të gjyqtarëve nga komuniteti serb. Po ashtu, sfiduese për gjykatën ka qenë edhe mungesa e stafit profesional dhe administrativ, për shkak të dorëheqjeve të stafit nga po i njëjti komunitet.

Implementimi i Planit të Punës së Gjykatës Themelore Mitrovicë

Nga gjithsej 22 aktivitete të planifikuara, prej tyre janë përmbushur 95%.



PJESA E KATËRT

11. AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është organ administrativ profesional, i cili në kuadër të tij ka strukturën e vet organizative me të cilën ofron mbështetje profesionale dhe administrative Këshillit dhe gjykatave. Ky organ, përbëhet nga nëpunësit civil dhe zyrtarët e angazhuar në bazë të marrëveshjeve të veçanta të cilët përbëjnë administratën qendrore të sistemit gjyqësor.

Brenda strukturës së tij, Sekretariati ka këtë rregullim organizativ:

- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit;
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Zyra për Integritet Evropian;
- Zyra për Përkthime;
- Departamenti për Teknologji Informativ;
- Departamenti për Logjistikë dhe Infrastrukturë;
- Departamenti për Çështje Ligjore;
- Departamenti për Buxhet dhe Financa;
- Departamenti për Prokurim;
- Departamenti për Evidencë Qendrore Penale.

11.1 Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit

Bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit është Zyrtari Kryesor Administrativ.

Drejtori i Përgjithshëm në kuadër të përgjegjësive të tij, ndër të tjera ka nxjerr, 486 vendime të ndryshme, ndërsa pas përfundimit të procedurave rekrutuese, drejtori ka nënshkruar 135 akt emërimi lidhur me konkurse të jashtme dhe 156 marrëveshje për shërbime të veçanta.

Në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm funksionon, Certifikuesi i cili është përgjegjës që të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes, ose autorizimit të pagesave sipas kontratës. Të sigurojë që shpenzimi i parave publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me Rregullat e KMF, si dhe ushtron të gjitha detyrat të cilat i janë caktuar atij/asaj sipas Rregullave KMF (kontrollimi dhe menaxhimi financiar).

Aktivitetet kryesore të zyrtarit certifikues përfshijnë: pranimin, regjistrimin dhe shqyrtimin e lëndëve si dhe aprovimin e tyre në SIMFK. Janë pranuar dhe aprovuar gjithsejtë 2,855 lëndë, në vlerë për 4,362,799.98€ të kategorive të ndryshme ekonomike, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, mallra dhe shërbime si dhe shpenzime kapitale.

11.2 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për udhëheqjen, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave ligjore në SKGJK-së, NJIGJ dhe gjykata, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli.

Me Ligjin për buxhetin e vitit 2023, janë lejuar 2.321 pozita, me ç'rast buxheti i KGJK-së për të punësuar, në krahasim me vitin 2022 është rritur për 50 pozita apo 2.2%.

Në kuadër të KGJK-së, kemi 2 programe buxhetore:

1. Programi buxhetor i SKGJK-së: 2.294 pozita dhe
2. Programi buxhetor i NJIGJ: 27 pozita.

KGJK, ka aprovuar Planin e personelit për vitin 2023 për:

- KGJK, SKGJK, gjykatat dhe degët e tyre: 2.294 pozita, prej të cilave 474 pozita janë paraparë për gjyqtarë dhe 1.820 pozita për të punësuar tjerë, dhe
- Programi buxhetor i NJIGJ: 27 pozita.

Për periudhën raportuese, sistemi gjyqësor ka gjithsejtë 2.107 të punësuar, të pasqyruara detajisht në tabelën më poshtë:

Të punësuarit në sistem gjyqësor (KGJK, SKGJK, NJIGJ, Gjykata)								
Gjithsej	Totali i të punësuarve	sipas gjinisë		sipas nacionalitetit				
		Femra	Meshkuj	Shqiptar	Serb	Boshnjak	Turk	Tjerë
Totali	2.107	1.036	1.071	1.828	237	28	10	4
%	100.0%	49.17%	50.83%	86.76%	11.25%	1.33%	0.47%	0.19%
Nga totali i 2107 të punësuarve								
Anëtarët e KGJK-së	12	4	8	9	1	1	1	0
%	100.0%	33.3%	66.7%	75.0%	8.3%	8.3%	8.3%	0.0%
Gjyqtar	421	145	276	379	34	6	1	1
%	100.0%	34.44%	65.56%	90.02%	8.08%	1.42%	0.24%	0.24%
Të punësuarit tjerë	1674	887	787	1425	202	21	8	3
%	100.0%	53.0%	47.0%	85.1%	12.1%	1.3%	0.5%	0.2%

Gjatë periudhës raportuese, janë realizuar 181 rekrutime të reja, të pasqyruara detajisht në tabelën më poshtë:

Lloji i pozitës	Numri i pozitave të rekrutuara	Gjinia			
		Femra	%	Meshkuj	%
Gjyqtar	29	12	41.38%	17	58.62%
Bashkëpunëtor profesional	50	31	62.0%	19	38.0%
Udhëheqës i Zyrës	3	2	66.7%	1	33.3%
Referent	25	18	72.0%	7	28.0%
Zyrtar Ligjor	52	44	84.6%	8	15.4%
Zyrtar për Përkthime	5	3	60.0%	2	40.0%
Zyrtar i Teknologjisë Informative	2	1	50.0%	1	50.0%
Total	166	111	66.87%	55	33.13%

Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar gjithsejtë 47 avancime në detyrë të realizuara përmes konkurseve të brendshme.

Lloji i pozitës	Numri i pozitave të avancuar	Gjinia				Nacionaliteti							
		Femra	%	Meshkuj	%	Shqiptar	%	Serb	%	Boshnjak	%	Tjerë	%
Drejtor Departamenti	3	0	0.0%	3	100.0%	3	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Ndihmës administrator	3	1	33.3%	2	66.7%	3	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Udhëheqës Njësie dhe Zyre në SKGJK dhe gjykatë	22	11	50.0%	11	50.0%	22	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Mbikëqyrës sektori në gjykatë	7	1	14.3%	6	85.7%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Zyrtar profesional (referent, zyrtar logjistike)	12	1	8.3%	11	91.7%	12	100.0%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%
Total	47	14	29.8%	33	70.2%	40	85.1%	0	0.0%	0	0.0%	0	0.0%

Aktivitetet e tjera në lidhje me procedurat e rekrutimit															
Ndarja / dega	Anëtar Këshilli	Kryetar Gjykate	Gjyqtar mbikëqyrës	Gjykata e Apelit	DHPGJS	Departamenti special	Transferimi	Gjyqtar porot	Femra	Meshkuj	Shqiptar	Serb	Boshnjak	Turk	Tjere
Anëtar të KGJK-së nga Kuvendi	2								0	2	1	0	0	1	0
Gjykata Supreme e Kosovës		1							0	1	1	0	0	0	0
Gjyqtar mbikëqyrës			2						1	1	1	1	0	0	0
Avancim në Gjykatën e Apelit				3					0	3	3	0	0	0	0
Avancim në Dhomën e Posaçme					2				1	1	2	0	0	0	0
Avancim në Departament Special Gjykata Themelore Prishtinë						3			0	3	3	0	0	0	0
Transferim i përhershëm në Gjykatën Themelore Prishtinë							3		0	3	3	0	0	0	0
Emërim i gjyqtarëve prorot								85	43	42	81	3	0	0	1
Totali në gjykata	2	1	2	3	2	3	3	85	45	56	95	4	0	1	1

Janë përfunduar gjithsej 106 marrëdhënie të punës, shih tabelën për më shumë detaje:

Përfundimi i marrëdhënies së punës	TOTAL	Gjyqtar	%	Staf	%	GJINIA			
						Femra	%	Meshkuj	%
Pension	82	24	29.3%	58	70.7%	38	46.3%	44	53.7%
Dorëheqje	16	0	0.0%	16	100.0%	6	37.5%	11	68.8%
Shkarkim	3	2	66.7%	1	33.3%	2	66.7%	1	33.3%
Vdekje	5	1	20.0%	4	80.0%	2	40.0%	4	80.0%
Total	106	27	25.5%	79	74.5%	48	45.3%	60	56.6%

Pozitat e stafit mbështetës të angazhuar në gjykata përmes partnerëve, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

POZITA	Lloji i marrëveshjes	Pagesa	Total	GJINIA			
				Femra	%	Meshkuj	%
Zyrtar Ligjor me UNDP	Marrëveshje mes KGJK-UNDP	UNDP	20	14	70.0%	6	30.0%
Zyrtar ligjor në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme	Marrëveshje mes KGJK-AKP	AKP	17	17	100.0%	0	0.0%
Trajnere në Projektin SMIL në gjykata	Marrëveshje mes KGJK-TIK SMIL	TIK/ SMIL	21	13	61.9%	8	38.1%
Konsulent/e i/e përkohshëm ligjor/e në gjykata	Mbështetje nga EKOJUST / IRZ	EKOJUST/IRZ	26	21	80.8%	5	19.2%
Total			84	65	77.4%	19	22.6%

Të dhënat lidhur me masat disiplinore të shqiptuara ndaj të punësuarve në administratën gjyqësore:

- ✘ Pezullim i marrëdhënies së punës: 6 raste, prej të cilëve 2 raste të pezulluara këtë vit;
- ✘ Ndalimi i gradimit deri në 5 vite dhe transferi në gjykatë tjetër për 3 muaj: 1 rast;
- ✘ Pezullim i ushtrimit të detyrave: 1 rast;
- ✘ Ndalim i 1/3 e pagës për 1 muaj: 6 raste;
- ✘ Lirim nga përgjegjësia: 1 rast;
- ✘ Kthim në plotësim: 9 raste.

11.3 Zyra për Integritime Evropiane

Zyra për Integritime Evropiane është përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes profesionale, sigurimin e informacioneve të nevojshme, raportimin për sistemin gjyqësor, hartimin e strategjive, planeve dhe aktiviteteve në lidhje me procesin e integritimeve evropiane.

KGJK me qëllim të zbatimit të MSA-së, si dhe përmbushjes së obligimeve përmes Zyrës për Integritime Evropiane ka ofruar raportime të rregullta mbi zhvillimet në sistemin e drejtësisë si dhe ka marrë masat e duhura për përmbushjen e këtyre obligimeve dhe realizimin e reformave në sistemin gjyqësor.

Zyra ka koordinuar aktivitetet lidhur me:

- Zbatimin e obligimeve të dala nga MSA;
- Monitorimin dhe raportimin në zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian;
- Koordinimin e aktiviteteve të KGJK-së për mbështetje financiare nga Instrumenti i Para - Anëtarësimit (IPA);
- Është raportuar në lidhje me përmbushjen e obligimeve që KGJK ka marrë përsipër në zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane dhe Programin Kombëtar për Integritim Evropian (PKIE); Misionet Vlerësuese të TAIEX për Rishikim Kolegial në gjashtë (6) shtetet e Ballkanit Perëndimor;
- Ka bashkëpunuar me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në funksion të procesit të integritimit evropian.



11.4 Zyra për Përkthime

Zyra për Përkthime është përgjegjëse për përkthimin e të gjitha materialeve që ofrohen për përkthim nga Sekretariati dhe njësitë tjera të Këshillit, përfshirë përkthimin simultan dhe konsektiv gjatë takimeve të Këshillit dhe komisioneve të tij, mirëmbajtjen e regjistrave të përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor të certifikuar dhe emëruar nga Këshilli.

Aktivitetet e Zyrës:

- 5441 faqe përkthim me shkrim;
- Rreth 314 orë përkthim simultan dhe/ose konsektiv;
- 152 kandidatë të rinj për 7 çifte gjuhët e certifikuar;
- 290 kandidatë të ricertifikuar për 23 çifte gjuhësh;
- Draft Doracaku për punën e Përkthyesve dhe Interpretëve në Sistemin Gjyqësor të Kosovës;
- Draft Kodin e Etikës për Përkthyes dhe Interpretë Gjyqësorë;

Zyra e përkthimeve ka organizuar trajnime në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë në mbështetje të Projektit EUKOJUST dhe IOM-it për përkthyesit e gjykatave lidhur me përdorimin e koncepteve ligjore dhe ka prezantuar doracakun për punën e përkthyesve në gjykata.

11.5 Departamenti për Teknologji Informative

Departamenti për Teknologji Informative është përgjegjës për administrimin dhe infrastrukturës së teknologjisë informative dhe të komunikimit elektronik për Këshill dhe gjykata, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.

Aktivitetet e Departamentit që kanë vazhduar edhe gjatë vitit raportues lidhur me:

- Sistemin e Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL);
- Ndërlidhjen e SMIL-it me Sistemin Qendror Kombëtar i Evidencës Penale;
- Projekti i audio - video incizimit të seancave gjyqësore;
- Projekti i dosjes elektronike të gjyqtarëve.

Aktivitetet kryesore të realizuara:

- Zbatimi i SMIL në Gjykatën Komerciale;
- Zbatimi i kritereve të reja të shpërndarjes automatike të lëndëve lidhur me caktimin e lëndëve për dhunë në familje;

- Zhvillimi i regjistrimit të veçantë për gjenerimin e të dhënave nga SMIL të cilat kërkohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Fillimi i fazës testuese për ndërlidhjen e SMIL me sistemin e lëndëve të dhunës në familje në Ministrinë e Drejtësisë;
- Vlerësimi dhe ofrimi i trajnimeve për gjyqtar dhe stafin e administratës të gjykatave për përdorim të SMIL-it;
- Vlerësimi dhe ofrimi i trajnimeve për të punësuarit në gjykata lidhur me ngritjen e vetëdijësimit dhe nivelit të sigurisë kibernetike;
- Vlerësimi i digjitalizimit për Gjykatën Komerciale përmes projektit të USAID - Justice Activity;
- Hartimi i Draft Strategjisë së TIK-ut për periudhën 2024 - 2029, në bashkëpunim me KAGJ dhe me mbështetjen e Këshillit të Evropës/CEPEJ;
- Zhvillimi i sistemit për financa;
- Zhvillimi i sistemit për administratën gjyqësore.

11.6 Departamenti për Logjistikë dhe Infrastrukturë

Departamenti për Logjistikë dhe Infrastrukturë është përgjegjës dhe siguron që Këshilli dhe gjykatat të kenë furnizim të duhur dhe me kohe me materialet e nevojshme për funksionimin efikas dhe efektiv, përfshirë mbështetjen logjistike dhe me infrastrukturë ndërtimore, automjetet e transportit, sigurinë fizike dhe administrimin e dokumenteve të arkivit në Këshill.

Departamenti ka realizuar këto aktivitete:

- Kanë filluar punimet në projektet për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Viti dhe për renovimin e objektit të ish Jugobankës për Gjykatën Themelore në Mitrovicë, si dhe kanë vazhduar punimet për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Glllogoc;
- Janë përgatitur të dhënat teknike dhe është publikuar punimi i projektit për Gjykatën Themelore në Prizren dhe në Pejë;
- Janë realizuar kërkesat e gjykatave për investimet kapitale që lidhen me riparimet e nevojshme të objekteve ekzistuese;
- Janë mbështetur gjykatat në përdorimin, futjen e të dhënave dhe regjistrimin e pasurisë në sistemin elektronik E-pasuria për zyrtarët e logjistikës dhe pasurisë;
- Është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm me Komunën e Prishtinës, për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Arkivit Qendror të gjykatave në Pallatin e Drejtësisë.

Investimet për projektet kapitale që janë realizuar:

- Projekti për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë është përfunduar dhe është bërë pranimi teknik, vlera totale e të cilit është 800.229.53€;
- Projekti për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Glllogoc është filluar dhe deri më tani kemi realizuar pagesa në vlerë 284,886.90€;
- Projekti për renovimin e objektit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë të Jugut (ish Jugobanka) është filluar dhe deri më tani kemi realizuar pagesa në vlerë 141,932.00€;
- Projekti për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti është filluar dhe deri më tani kemi realizuar pagesa në vlerë 210,161.81€;
- Është punuar projekti kryesor i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren, sipas Projektit për dizajnimin dhe ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Prizren, kontrata e të cilit nuk ka filluar për shkak të procedurave ankimore në Organin Shqyrtues të Prokurimit;
- Janë zhvilluar procedurat e prokurimit për Projektin e dizajnit dhe ndërtimit të objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, aktivitetet e së cilit janë pezulluar për shkak të procedurave ankimore në Organin Shqyrtues të Prokurimit;
- Janë realizuar shërbime sipas Projektit për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve në objektet e gjykatave të Kosovës, bazuar në nevojat dhe kërkesat e gjykatave.

Riparimi dhe mirëmbajta e objekteve të SKGJK-së dhe gjykatave	
Gjykata Themelore në Prishtinë	8.059,15€
Gjykata e Apelit	1.274,48€
Gjykata Themelore në Gjilan	42.153,17€
Gjykata Themelore në Ferizaj	3.931,22€
Gjykata Themelore në Pejë	1.309,37€
Gjykata Themelore Gjakovë, dega në Malishevë	8.344,21€
Gjykata Themelore në Mitrovicë - Objekti në Jug	16.340,00€
Gjykata Themelore në Mitrovicë	20.846,84€
Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë	21.407,13€
Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega në Rahovec	13.485,57€
Gjykata Themelore në Prizren	7.774,76 €
Totali	144.925,90 €

Furnizimi me inventar për SKGJK dhe gjykata	
Kontrata e SKGJK-së	
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2380.00€
Gjykata Komerciale	10000.00€
Gjykata Themelore në Prishtinë	2420.00€
Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Fushë Kosovë	39979.10€
Gjykata Themelore në Ferizaj	18996.00€
Gjykata Themelore në Pejë	400.00€
Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Istog	4940.00€
Gjykata Themelore në Mitrovicë, Objekti në Jug	3465.00€
Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtri	365.00€
Gjykata Themelore në Gjakovë	19978.50€
Gjykata Themelore në Prizren	14760.00€
Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega në Rahovec	1390.00€
Totali	119073.60€

Furnizimi me inventar për SKGJK dhe gjykata	
Kontrata e Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP)	
KGJK dhe gjykata: 260 karrika	17940.00 €
KGJK dhe gjykata: 290 karrika	20010.00 €
Totali	37950.00 €

Shërbimet dhe furnizimet tjera në gjykata

Servisimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore në gjykata dhe KGJK	14.010,00 €
Servisimi dhe mirëmbajtja e klimave në KGJK dhe gjykata	14.957,00 €
Furnizimi me material të ndryshëm zyrtar - kontratë e AQP-së	43,748.77€
Furnizimi me letër për kopje: Kontratë e AQP-së	82,617.15€
Furnizim me material të shtypur për gjykata dhe SKGJK	84,478.07€
Furnizimi me flamuj	984€
Furnizimi me ID për ekspert gjyqësor	973.44€
Furnizimi me notes, kimik dhe kalendar tavoline	5,700€
Furnizimi me pliko	980€
Furnizimi me goma për automjete: Kontratë e AQP-së	2,662.80€

Është bërë asgjësimi i lëndëve gjyqësore nëpër gjykata sipas kontratës 'Asgjësimi me grirje dhe riciklim të dokumenteve prej letre në gjykata', me detaje si në tabelën në vijim:

Gjykata	Lëndët e asgjësuar (sasia në kg)
Regjioni Prishtinë	
SKGJK	3800
Gjykata Themelore në Prishtinë	9000
Gjykata Themelore në Prishtinë Dega Drenas	3500
Regjioni Pejë	
Gjykata Themelore në Pejë	4000
Gjykata Themelore në Pejë Dega Deçan	4000
Gjykata Themelore në Pejë Dega Klinë	3800
Gjykata Themelore në Pejë Dega Istog	1000
Regjioni Gjakovë	
Gjykata Themelore në Gjakovë	7760
Gjykata Themelore në Gjakovë Dega Malishevë	3020
Gjykata Themelore në Gjakovë Dega Rahovec	1800
Regjioni Mitrovicë	
Gjykata Themelore në Mitrovicë – Objekti Jug	7220
Gjykata Themelore në Mitrovicë Dega Skenderaj	3800
Gjykata Themelore në Mitrovicë Dega Vushtrri	3700
Regjioni Prizren	
Gjykata Themelore në Prizren	18700
Gjykata Themelore në Prizren Dega Dragash	770
Gjykata Themelore në Prizren Dega Suhareke	3200
Regjioni Gjilan	
Gjykata Themelore në Gjilan	13040
Gjykata Themelore në Gjilan Dega Novoberde	340
Gjykata Themelore në Gjilan Dega Kamenicë	3600
Gjykata Themelore në Gjilan Dega Viti	4330
Regjioni Ferizaj	
Gjykata Themelore në Ferizaj	5000
Gjykata Themelore në Ferizaj Dega Shterpce	280
Gjykata Themelore në Gjilan Dega Kaçanik	3800
Gjithsej	109460kg = 109.46ton

Departamenti, ka ofruar edhe shërbimin e transportit, përmes 141 automjete, 88 prej tyre pronë e KGJK-së dhe 53 automjete të tjera me qira. Po ashtu, në Pallatin e Drejtësisë është vendosur qendra e monitorimit me kamera me vlerë 19.090,00€, projekt i cili për shkak të mungesës së buxhetit nuk është realizuar edhe në objektet e gjykatave të tjera.

Aktivitetet e Divizionit për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv:

- 3560 shkresa të protokolluara;
- 1960 shkresa të dorëzuara në institucione tjera dhe gjykata;
- 2018 shkresa të pranuar;
- 3582 dosje të arkivuara;
- 2283 aplikacione për pozita të ndryshme;
- 1387 lëndë për pagesa të ndryshme për personel;
- 251,301.09€ pagesa për punë jashtë orarit dhe kujdestari;
- 24 përgjigje në ankesat e palëve për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil.

11.7 Departamenti për Çështje Ligjore

Departamenti për Çështje Ligjore, është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale lidhur hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve juridike të Këshillit.

Departamenti ka vazhduar mbështetjen e komisioneve të përhershme dhe ad hoc të Këshillit, paneleve si dhe përfaqësimit e Këshillit në konteste gjyqësore dhe procedura administrative. Gjithashtu, Departamenti ka mbështetur:

- Panelin për Lirim me Kusht;
- Asamblenë e Kryetarëve dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
- Komisionin për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose Arrestuar pa arsye;
- Komitetin Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore;
- KGJK-në në zhvillimin e procedurës disiplinore për gjyqtarë, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe aktet e miratuara nga Këshilli.

Po ashtu, Departamenti kryeson në vazhdimësi Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK.

Hartimi i akteve nënligjore:

- Draft Rregulloren për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin e Dosjes Elektronike për gjyqtar;
- Draft Rregulloren për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin e Dosjes Elektronike të Administratës Gjyqësore;
- Draft Rregulloren për Punën e Panelit për Lirim me Kusht;

Departamenti ka përfaqësuar KGJK-në në 180 konteste gjyqësore ku shumica prej tyre kanë qenë kompensim dëmi për personat e privuar nga liria, paga jubilarë, konflikte administrative, kompensime tjera dhe raste tjera për procedurë përmbarimore.

Janë përpiluar:

- 90 përgjigje në padi;
- Mbi 40 ankesa të ushtruara ndaj vendimeve të shkallës së parë;
- Mbi 20 revizione;
- 19 prapësime;
- 43 vendime dhe 3 njoftime nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së;
- Mbi 300 përgjigje ndaj shkresave/parashtesave të pranuar nga personat fizik;
- 568 vendime të nxjerra nga Këshilli;
- Mbi 120 opinione/memo shpjeguese.

Zyrtarët e Departamentit kanë marrë pjesë në cilësi të anëtarit në hartimin e raportit të 'Auditimit të të dhënave statistikore dhe krahasimi i të dhënave të punës së gjyqtarit I.G. për periudhën e vlerësimit 2018 - 2020', me të dhënat e ofruara nga Zyrës së Statistikave në kuadër të NJIGJ. Gjithashtu, kanë përfaqësuar KGJK-në në grupe punuese me Institucionet e tjera të vendit.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe është hartuar edhe raporti 'Analizimi i të dhënave statistikore për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye', më këtë raport është bërë analizimi i kompensimit të dëmit për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Departamenti ka vazhduar mbështetjen Komisionit për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 - 2025 dhe Planin Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimin të organizuar 2022 - 2024.

Gjithashtu, ka përgatitur Raportin për Implementimin e Planit të Veprimit lidhur me Strategjinë e Sundimit të Ligjit 2022-2026 si dhe Planin e Punës së KGJK-së për vitin 2023.



11.8 Departamenti për Buxhet dhe Financa

Departamenti për Buxhet dhe Financa është përgjegjës për planifikimin, menaxhimin, ekzekutimin e shpenzimeve buxhetore dhe arkëtimin e të hyrave dhe depozitave gjyqësore për nevojat e Këshillit, njësite të Këshillit dhe gjykatave, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Departamenti ka realizuar këto aktivitete:

- Ekzekutimi i buxhetit të KGJK-së sipas ndarjeve buxhetore në Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024 - 2026 drejtuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Planifikimi i buxhetit 2024 - 2026 sipas çarkores buxhetore 2024/01;
- Përgatitja e kërkesave buxhetore 2024 - 2026 drejtuar Kuvendit, Qeverisë dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Zotimi dhe shpenzimi i buxhetit për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale, subvencioneve dhe transfereve si dhe shpenzimeve kapitale sipas planifikimit buxhetor;
- Regjistrimi i transaksioneve në regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit (SIMFK) si dhe mbajtja e evidencës kontabël në formatin e raportimit sintetik dhe analitik në SKGJK-së;
- Përgatitja e raporteve mujore financiare të buxhetit dhe të hyrave;
- Përgatitja e raporteve mujore për obligimet e papaguara dhe obligimet kontraktuale për Thesarin në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Për shkak të mosfunktionalizimit të sistemit "E-pasuria" nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, SKGJK ka kërkuar funksionalizimin e këtij sistemi, ashtu që pas nënshkrimit të kontratës për mirëmbajtje janë ndërmarr disa veprime nga ana e MPBAP dhe sistemi ka filluar të funksionalizohet pjesërisht;
- Përgatitja e raporteve për procesin e pajtueshmërisë së regjistrave kontabël në SIMFK dhe regjistrave kontabël të KGJK-së, përkatësisht barazimi mujor i të hyrave dhe shpenzimeve për Thesarin në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Përgatitja e pasqyrave vjetore financiare të KGJK-së për vitin 2022;
- Përgatitja e Planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA për vitin 2022.

Po ashtu është përgatit:

- Pyetëtori i Vetëvlerësimit;
- Deklarata e Menaxhmentit për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll;
- Raporti Vjetor për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm si dhe Regjistri i Rreziqeve drejtuar Njësia Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Hartimi i akteve:

- Draft Udhëzimi Administrativ për Procedurat e Përdorimit dhe Menaxhimit të Parave të Imëta për Gjykata dhe Njësitë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Draft Udhëzimi Administrativ për Pranimin dhe Menaxhimin e të Hyrave dhe Depozitave Gjyqësore;
- Draft Udhëzimi Administrativ për Procedurat për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike;
- Draft Manuali (protokolli) për buxhet dhe financa – aneks i draft Rregullores për Organizimin dhe Veprimtarin e Brendshme të Gjykatave.

11.9 Departamenti i Prokurimit

Departamenti i Prokurimit është përgjegjës për kryerjen e të gjitha aktiviteteve të prokurimit për nevojat e Këshillit dhe gjykatave, në pajtueshmëri me Planin e Prokurimit dhe nevojat e identifikuar, siç përcaktohet me legjislacionit në fuqi. Departamenti ka realizuar 30 kontrata publike për punë, shërbime dhe furnizime. Kontratat publike janë të ndara sipas procedurave të prokurimit publik:

- **1 kontratë publike me procedurë të negociuar:**
 - shërbime shtesë në kontratën për projektimin dhe mbikëqyrjen e objektit të ri të gjykatës në Glllogoc.
- **5 kontrata publike me vlerë të madhe:**
 - ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan Dega në Viti;
 - renovimi i objektit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë objekti Jug;
 - furnizim me Inventar për salla të gjykimeve dhe zyra të shkrimoreve për gjykata dhe SKGJK;
 - blerja e 222 kompjuter pajisjeve të TI-së për SKGJK;
 - mirëmbajtja higjienike e objekteve të Pallatit të Drejtësisë dhe gjykatave.

- **8 kontrata publike me vlerë të mesme:**

- furnizimi dhe instalimi i pajisjeve në qendrën e monitorimit të kamerave në Pallatin e Drejtësisë;
- auditim të jashtëm të Projektit SMIL;
- LOT 1: Furnizim me licenca softuerike;
- LOT 2: Furnizim me licenca softuerike dhe SSL certifikate;
- servisimi dhe mirëmbajtja e 5 automjeteve të KGJK-së dhe gjykatave;
- servisimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të klimatizimit dhe ventilimit në objektet e gjykatave;
- dhënia në shfrytëzim të hapësirave brenda objektit të KGJK-së për shërbim me pije;
- shërbimet e transportit ajror për KGJK dhe gjykata.

- **5 kontrata publike me kuotimit:**

- publikimi të pozitive të lira në mjetet e informimit;
- blerjen e 3 kompjuterëve dhe 6 monitorëve për zyrën e Projektit TIK/SMIL;
- kompjuterë All-in-One për nevoja të projektit të audion dhe video incizimit;
- furnizim me notes, kimika dhe kalendar tavoline për zyrtare të KGJK dhe gjykatave;
- blerjen e pajisjeve të TIK, për Projektin Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve SMIL.

- **11 kontrata me vlerë minimale:**

- punimi i logos në sallën e takimeve të KGJK-së;
- blerjen e trakeve (kasetës) për barkod;
- punimi i ID kartelave për ekspert gjyqësor;
- pastrimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega Fushë Kosovë;
- ankandi shpallje publike për asgjësimin me grirje dhe riciklim të dokumenteve prej letre në gjykata;
- furnizim me material zyrtar;
- furnizim me ujë te pijes;
- blerjen e dhuratave (suvenirave) për KGJK;
- furnizim me flamuj;
- punimi i ID-ve për kartelat e eksperteve për nevojat e Sekretariatit dhe gjykatave;
- furnizim me Pliko për nevojat e KGJK-së dhe gjykatave.

Aktivitetet në zhvillim:

- Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren, faza e parë;
- Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë;
- Shërbimi për mirëmbajtje dhe përmirësime në Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Mercedes Benz AMG E 43;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemi të shuarjes automatike të zjarrit (aerosol) dhe aparate kundër zjarrit në gjykatat e Kosovës dhe në SKGJK;
- Kontrata për pastrimin të veturave të KGJK-së dhe gjykatave.

11.10 Departamenti i Evidencës Qendrore Penale

Departamenti i Evidencës Qendrore Penale është përgjegjëse për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në menaxhimin e regjistrit kombëtar të personave të dënuar.

Këtë vit, është funksionalizuar në tërësi Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Republikës së Kosovës, me ç'rast Departamenti ka ndërmarr të gjitha aktivitetet e nevojshme. KGJK ka zhvilluar procesin e ngritjes së kapaciteteve të rregullta njerëzore dhe teknike në të gjitha gjykatat themelore dhe degët e tyre përkatëse.

Aktivitetet e Departamentit:

- Ka vazhduar procesi i regjistrimit të lëndëve të reja penale në të gjitha gjykatat themelore në data bazën qendrore të SQEPRK-së, në total u proceduan 16759 lëndë të reja penale;
- Kanë vazhduar aktivitetet në finalizimin e procesit të ngritjes dhe ndërtimit të data bazës qendrore të evidencës penale, e cila është operative në të gjitha gjykatat e vendit;
- Është përgatitur draft plotësim ndryshimin e Rregullores mbi Evidencën Penale në Republikën e Kosovës;
- Janë finalizuar shumica e procedurave standarde të veprimit të cilat përfshijnë proceset kryesore në kuadër të operimit të sistemit;
- Ka vazhduar procesi i rregullt i lëshimit të certifikatave të gjendjes penale, me bazë në SQEPRK, të cilat mund të tërhiqen përmes platformës shtetërore online e-Kosova dhe fizikisht në të gjitha gjykatat themelore me degët e tyre;

- Ka vazhduar procesi i rregullt i ofrimit të shërbimeve të evidencës penale për institucionet e vendit, dhe shtetet e huaja konfor rregullave për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështje penale;
- Ka vazhduar procesin e rregullt të rehabilitimit ligjor dhe fshirjes së dënimeve të cilat kanë arritur afatet e fshirjes nga evidenca e personave të dënuar - rehabilitimi ligjor;
- Ka vazhduar procesi i skanimit të të gjitha aktgjykimeve penale të formës së prerë në gjykatat e vendit;
- Ka vazhduar përditësimi dhe plotësimi i të dhënave penale në sistem dhe është administruar procesi i menaxhimit të të dhënave penale;
- Ka vazhduar bashkëpunimi me institucionet relevanteshtetërore, në funksion të realizimit të mandatit të saj.

Lidhur me gjendjen aktuale të të dhënave në Sistemin Qendror të Evidencës Penale, shih tabelën:

Nr. i rasteve në Sistemin Qëndror të Evidencës Penale		34.3491
Nr. i rasteve të regjistruara në sistem		16.759
Nr. i personave të dënuar		11.185
Nr. i rasteve të evidentuara në gjykatat themelore dhe degët e tyre (lëndë të regjistruara në vitin 2022)	Gj.Th.Prishtinë	5.677
	Gj.Th.Prizren	2.220
	Gj.Th.Ferizaj	2.251
	Gj.Th.Pejë	1.388
	Gj.Th.Gjilan	3.019
	Gj.Th.Mitrovicë	1.076
	Gj.Th.Gjakovë	1.128
Nr. i certifikatave mbi dënimet penale të lëshuara nga sistemi deri më 31 dhjetor 2022		250.339
Nr. i certifikatave mbi dënimet penale të lëshuara përmes portalit shtetëror 'e - Kosova'		109.392
Nr. i certifikatave mbi dënimet penale të lëshuara në gjykata		140.947
Shërbime të ofruara të gjendjes penale për institucione		10.119
Nr. i dënimeve të shlyera nga evidenca e personave të dënuar - rehabilitim ligjor		154.775
Numri i aktgjykimeve të skanuara		201.173
Nr. i dëshmimeve mbi ekzekutimin e dënimeve penale të ngarkuara në sistem		6.859

12. AKTIVITETET E NJËSISË PËR INSPEKTIM GJYQËSOR

Njësia për Inspektim Gjyqësor (NJIGJ) është përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes profesionale dhe administrative për Këshillin Gjyqësor dhe komisionet përkatëse të tij në vlerësimin e punës së gjykatave.

Brenda strukturës së tij, NJIGJ ka këtë rregullim organizativ:

- Zyra e Drejtorit të Njesisë;
- Zyra për Statistika;
- Zyra për Vlerësim dhe Verifikim;
- Zyra për Performancë dhe Inspektim;
- Zyra për Disiplinim.

12.1 Zyra e Drejtorit të Njesisë

Drejtori i Njesisë është përgjegjës para Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Njesisë, në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi. Drejtori i Njesisë i raporton Këshillit dhe kryesuesit të Këshillit për punën e tij.

Krahas akteve të tjera të hartuara nga NJIGJ, Drejtori i Njesisë ka hartuar Doracakun për Procedurat Standarde Operuese të Njesisë.

12.2 Zyra për Statistika

Zyra është përgjegjëse për të ofruar përkrahje profesionale Këshillit dhe komisioneve lidhur me çështje që kanë të bëjnë me statistikat për punën në gjykata, si dhe përgatitjen e analizave krahasuese të statistikave që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor.

Aktivitetet e Zyrës:

- Përgatitja e raportit statistikor të rregullt për punën e gjykatave për vitin 2022;
- Përgatitja e raporteve statistikore për vitin 2022 për secilin gjyqtar;
- Përgatitja e raportit për Zyrën e Integriteteve Evropiane në SKGJK për vitin 2022;
- Përgatitja e regjistrave të gjykatave për publikim për secilën lëmi për vitin 2022;
- Barazimi i lëndëve për secilin gjyqtar me SMIL, pra barazimi i gjendjes fizike në zyrën e gjyqtarit me SMIL;
- Përgatitja e raportit statistikor të rregullt për punën e gjykatave për tremujorin e I-rë 2023;

- Përgatitja e regjistrave të gjykatave për publikim për secilën lëmi për tremujorin e I-rë 2023;
- Përgatitja e raportit për Zyrën e Integriteteve Evropiane në SKGJK për tremujorin e I-rë 2023;
- Përgatitja e raportit statistikor të rregullt për punën e gjykatave për tremujorin e II-të 2023;
- Përgatitja e raportit për Zyrën e Integriteteve Evropiane në SKGJK për tremujorin e II-të 2023;
- Përgatitja e regjistrave të gjykatave për publikim për secilën lëmi për gjashtëmujorin e I-rë 2023;
- Përgatitja e raportit statistikor të rregullt për punën e gjykatave për gjashtëmujorin e I-rë 2023;
- Përgatitja e raportit statistikor të rregullt për punën e gjykatave për nëntëmujorin 2023;
- Përgatitja e regjistrave të gjykatave për publikim për secilën lëmi për nëntëmujorin 2023;
- Përgatitja e raportit për Zyrën e Integriteteve Evropiane në SKGJK për nëntëmujorin 2023;
- Barazimi i lëndëve për gjyqtarët, gjendja fizike në zyre të gjyqtarit me të dhënat në SMIL;
- Barazimi i lëndëve në nivel të gjykatave për të gjitha lëmit;
- Krijimi i regjistrave statistikor për Agjencinë e Statistikave të Kosovës;
- Mbështetje të komisioneve të KGJK-së dhe zyrave të KGJK-së, sipas nevojës;
- Mbështetje për Gjykatën Themelore në Prishtinë lidhur me bartjen e lëndëve në Degën në Fushë Kosovë përmes SMIL.



12.3 Zyra për Vlerësim dhe Verifikim

Zyra është përgjegjëse për mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave të nevojshme, të cilat komisionit do t'i shërbejnë për verifikimin dhe vlerësimin e integritetit personal dhe profesional të kandidatit, në procedurën e rekrutimit apo avansimit, duke respektuar aktet dhe standardet ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ligjet e aplikueshme dhe akteve të miratuara nga Këshilli.

Zyra ka bashkëpunuar me gjykatat dhe prokuroritë, si dhe insitucione të tjera vendore, për të siguruar dhe verifikuar informatat e duhura lidhur me kandidatët.

Po ashtu, ka ofruar mbështetje lidhur me konkuset e shpallura nga KGJK, si në vijim:

- Ngritje në detyrë:
 - Konkurs i brendshëm për pozitën e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës;
 - Konkurs i brendshëm për 3 pozita të Dhomës së Shkallës së I-rë të Gjykatës Komerciale;
 - Konkurs i brendshëm për gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Fushë Kosovë, për dy radhët;
 - Konkurs i brendshëm për 4 pozita në Gjykatën e Apelit;
 - Konkurs i brendshëm për 3 pozita në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Special;
 - Konkurs i brendshëm për gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë;
 - Konkurs i brendshëm për një pozitë në Kolegjin e Apelit si shkallë e II-të e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe 2 pozita për shkallën e I-rë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës;
 - Konkurs i brendshëm për pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës;
 - Konkurs i brendshëm për gjyqtar nga komiuniteti serb, në shkallën e I-rë dhe të II-të, të Gjykatës Komerciale;
 - Konkurs i brendshëm për 7 gjyqtar në Gjykatën e Apelit, prej të cilave 1 pozitë e rezervuar për komunitetin serb;
 - Konkurs i brendshëm gjyqtar në Departamentin Special të Gjykatës së Apelit.

- Rekrutimi i gjyqtarëve të rinj dhe personelit:
 - Konkursi për 37 pozita, prej të cilave 7 të rezervuara për komunitetin serb;
 - Konkursi për 47 pozita, prej të cilave 5 të rezervuara për komunitetin serb;
 - Konkursi për 8 pozita, prej të cilave 8 të rezervuara për komunitetin serb;
 - Konkursi për 40 pozita, për bashkëpunëtor profesional;
 - Konkursi për 36 pozita, për bashkëpunëtor profesional;
 - Konkursi për administrator të Gjykatës Komerciale dhe Gjykatës Themelore Prizren.

12.4 Zyra për Performancë dhe Inspektim

Zyra është përgjegjëse për inspektimin dhe vlerësimin e punës së gjykatave dhe aktiviteteve të tjera të zhvilluara brenda gjyqësorit, në drejtim të rritjes së efektivitetit dhe profesionalizmit brenda gjyqësorit, duke përfshirë mbështetjen profesionale dhe administrative të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve dhe KAGJ.

Aktivitetet e Zyrës:

Gjykata	Çështja/ Tema	Inspektim i Planifikuar/Ad Hoc
Gjykata Themelore Prizren	Rasti 'Kobra'	Ad hoc
Gjykata e Apelit dhe gjykatat themelore	Rishikimi i faktorit kohor në dërgim/pranimin e lëndëve gjyqësore sipas kompetencës lëndore dhe territoriale	I planifikuar
Gjykata Themelore Ferizaj, Gjilan dhe Prizren	Arsyet e parashkrimit të dënimit me burgim, dënimit me gjobë penale dhe dënimit me gjobë kundërvajtje	I planifikuar
Gjykata Themelore Prishtinë	Zvarritjet e drejtësisë për zbardhjen e krimit mbi adoleshentët	Ad hoc
Gjykata Themelore Prishtinë	Dosja e trashë e veprave penale	Ad hoc
Gjykata Themelore Ferizaj	Rishikimi i procesit të lëshimit të vërtetimeve SQEP	Ad hoc
Gjykata Themelore Prishtinë	Rishikimi i procesit të lëshimit të vërtetimeve SQEP	Ad hoc
Gjykata Themelore Ferizaj	Pretendimet për zvarritjen e çështjes civile C.nr.721/2021	Ad hoc
Gjykata Themelore Prishtinë	Pretendimet për zvarritje në dërgimin e lëndës civile C.nr. 88/2016 sipas ankesës në Gj. te Apelit	Ad hoc
Gjykatat themelore - Analizë statistikore	Zgjidhja efikase e lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar	I planifikuar
Gjykatat themelore dhe sipas kërkesës së kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryesuesit të KGJK-së	Caktimi i paraburgimit, kërkesat e adresuara për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme	Ad hoc

Detajet kryesore lidhur me çështjet/temat e inspektuara:

- Inspektimi i rastit 'Kobra' në Gjykatën Themelore në Prizren: [Linku i raportit](#)
- Inspektimi i çështjes së 'Rishikimi i faktorit kohor në dërgim/pranimin e lëndëve gjyqësore sipas kompetencës lëndore dhe territoriale', si rezultat i këtij inspektimi janë gjetur rreth 405 lëndë në pritje për dërgim në kompetencë.

- Inspektimi i çështjes me temë 'Arsyet e parashkrimit të dënimit me burgim, dënimit me gjobë në penale dhe dënimit me gjobë në kundërvajtje', ka pasur në fokus 3 gjykata themelore, përkatësisht Gjykatën Themelore Ferizaj, Gjilan dhe Prizren. Inspektimi është realizuar për 115 lëndë, prej tyre:
 - 19 lëndë, në të cilat është shqiptuar dënimi me burgim;
 - 36 lëndë, me dënim me gjobë;
 - 60 lëndë me dënim me gjobë në lëmin kundërvajtje.
- Inspektimi i çështjes 'Zvarritjet e drejtësisë për zbardhjen e krimit mbi adoleshentët', si rezultat i së cilës është gjetur se koha e kaluar nga momenti i bartjes së lëndës në Gjykatën Themelore në Prishtinë deri në marrjen e vendimit meritor (vetëm për një të akuzuar) është 10 vite e 4 muaj e 7 ditë.
- Inspektimi i çështjes së 'A.P', si rezultat i së cilit është konstatuar se rasti i të miturit/pandehurit A. P. është rasti i dytë i identifikuar në gjykatat e Republikës së Kosovës, që ka të bëjë me të pandehur recidivist, e që e kaluara kriminale nuk ka figuruar në dispozitiv të aktvendimit/aktgjyqimit.

Aktivitetet e Zyrës lidhur me inspektimet e kryera:

- Ekzekutimi i dënimit me burgim, gjobë dhe gjobë për kundërvajtje
 - Analizimi i formave të akteve përcjellëse
 - Llojet e veprave penale të parashkurara dhe
 - Gjendjen materiale të të dënuarve
- Dosjet/Shkresat e lëndës
- Politika ndëshkimore (matja e dënimit) dhe dispozitivi i aktgjyqimit
- Regjistrimi i rasteve me aktgjykim të formës së prerë në SQEP

Në bazë të shkeljeve të konstatuara në praktikë dhe të evidentuara nga inspektimet e bëra, Njësia ka rekomanduar stafin menaxhues të gjykatave që të veprojnë konform kompetencave ligjore, me qëllim të parandalimit dhe evidentimit të tyre.

12.5 Zyra për Disiplinim

Zyra është përgjegjëse për të ofruar përkrahje profesionale Këshillit dhe komisioneve lidhur me çështje që kanë të bëjnë me procedurat disiplinore për gjyqtarë dhe të punësuarve të tjerë brenda sistemit gjyqësor, në përputhje me ligjet e aplikueshme dhe aktet e miratuara nga Këshilli.

Për më shumë detaje lidhur me aktivitetet e Zyrës dhe procedurat disiplinore të gjyqtarëve, referohuni pikës 2.9 të këtij raporti.

PJESA E PESTË

13. Buxheti i Këshillit Gjyqësor

Buxheti i përgjithshëm i Këshillit Gjyqësor të Kosovës si organizatë buxhetore, së bashku me dymbëdhjetë programet e tij: Sekretariati i KGJK-së, Njësia për Inspektim Gjyqësor, Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit, Gjykata Komerciale dhe gjykatat themelore, për vitin 2023 sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës është 34,155,572.00€, për gjithsej 2,321 pozita.

Pjesëmarrja e buxhetit të KGJK-së, në buxhetin e Kosovës shprehur në përqindje është 1.06%.

13.1 Shpenzimet

Në vitin 2023, nuk ka pasur rishikim të buxhetit përveç ndryshimeve sipas kërkesave nga KGJK dhe vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe atë si në vijim:

- Shuma prej 24,425.96€ konfor nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-193 është transferuar nga projekti 'Riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve të gjykatave' tek projekti 'Dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Fushë Kosovë';
- Me kërkesë të KGJK-së:
 - Është transferuar nga projekti kapital 15513 'Dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Prizren', në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në programin buxhetor të SKGJK-së, shuma prej 150,000.00€;
 - Është transferuar nga projekti kapital 15513 'Dizajnimi dhe ndërtimi i gjykatës themelore në Prizren' shuma prej 300,000.00 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në programin buxhetor të SKGJK-së shuma prej 150,000.00€ dhe programin buxhetor të GjTh Prishtinë në shumë prej 150,000.00€;
 - Për kursime dhe transfere në kuadër të kategorive, ka pasur ndryshim në buxhet, më konkretisht në kategorinë mallra dhe shërbime ka pasur zvogëlim të buxhetit në programin buxhetor të Gjykatës Supreme në shumë prej 110,000.00€, në programin buxhetor të Gjykatës Komerciale ka pasur zvogëlim në shumë prej 10,000.00€, si dhe në programin buxhetor të Gjykatës Themelore në Mitrovicë ka pasur zvogëlim prej 20,000.00€.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale ka pasur zvogëlim në total prej 725,000.00€, përkatësisht në projektet si në vijim:

- Dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Prizren: 250,000.00€;
- Dizajnimi dhe ndërtimi i objektit të Arkivit Qendror të Gjykatave dhe Gjykatës Supreme: 100,000.00€;
- Renovimi i objektit të Gjykatës Themelore në Mitrovicën e Jugut: 200,000.00€;
- Dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Pejë: 75,000.00€;
- Dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, dega në Viti: 100,000.00€.

Sipas vendimit përkatës, ka pasur rritje të buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime në shumë prej 490,000.00€, përkatësisht në programet buxhetore:


- Gjykatat dhe Sekretariati | Mallra dhe Shërbime: 150,000.00€;
- Gjykata Themelore Pejë | Mallra dhe Shërbime: 60,000.00€;
- Gjykata Themelore Prishtinë | Mallra dhe Shërbime: 140,000.00€;
- Gjykata Themelore Prizren | Mallra dhe Shërbime: 70,000.00€;
- Gjykata Themelore Gjilan | Mallra dhe Shërbime: 35,000.00€;
- Gjykata Themelore Ferizaj | Mallra dhe Shërbime: 35,000.00€.

Me vendimin e Qeverisë Nr.69/2023, kategoria paga dhe shtesa është zvogëluar për 1,300,695.86€, përkatësisht programi buxhetor i SKGJK-së (33300) në shumë prej 1,035,371.69€ dhe programi buxhetor i NjIGj (33800) në shumë prej 265,324.17 €.

Buxheti final pas këtyre ndryshimeve është: 32,888,599.39€, ndërsa pjesëmarrja e buxhetit të KGJK-së, në buxhetin e Kosovës, shprehur në përqindje është 1.02%.

Për më shumë detaje rreth buxhetit për shpenzimet e KGJK-së gjatë këtij viti, shih tabelën:

Kategoritë ekonomike	Buxheti 2023	Buxheti i zotuar	Buxheti zotuar %	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i shpenzuar %
Paga dhe shtesa	24,396,876.09	23,329,628.28	95.63%	23,329,628.28	95.63%
Mallra dhe shërbime	5,228,000.00	5,162,345.32	98.74%	5,067,562.08	96.93%
Shpenzime komunale	400,000.00	331,653.94	82.91%	325,475.12	81.37%
Subvencione dhe transfere	500,121.92	499,850.11	99.95%	497,006.48	99.38%
Shpenzime kapitale	1,955,000.00	1,865,224.10	95.41%	1,305,320.00	66.77%
Donacione	408,601.38	267,364.89	65.43%	256,805.88	62.85%
Totali	32,888,599.39	21,704,750.09	95.64%	30,781,797.84	93.59%



Siç shihet në tabelë, ky buxhet është zotuar në shumën e përgjithshme prej 21,704,750.09€ apo 93.59% ndërsa është shpenzuar 30,781,797.84€ apo 93.59%.


Sipas kategorive ekonomike, buxheti i përgjithshëm i KGJK-së është zotuar dhe shpenzuar, si në vijim:

- **Paga dhe Shtesa:** Nga shuma vjetore e buxhetit, prej 24,396,876.09€ janë zotuar dhe shpenzuar 23,329,628.28€ apo 95.63%.
- **Mallra dhe Shërbime:** Nga shuma e buxhetit prej 5,228,000.00€, janë zotuar 5,162,345.32€ apo 98.74%, ndërsa janë shpenzuar 5,067,562.08€ apo 96.63%.
- **Shpenzime Komunale:** Nga shuma vjetore e buxhetit prej 400,000.00€ janë zotuar 331,653.94€ apo 82.81%, ndërsa janë shpenzuar 325,475.12€ apo përqindje 81.37%.
- **Subvencione dhe Transfere:** Nga shuma vjetore e buxhetit (nga të hyrat) prej 500,121.92€ janë zotuar 499,850.11€ apo 99.950%, ndërsa janë shpenzuar 497,006.48€ apo 99.38%.
- **Shpenzime Kapitale:** Nga shuma e buxhetit prej 1,955,000.00€ janë zotuar 1,865,224.10€ apo 95.41%, ndërsa janë shpenzuar 1,305,320.00€ apo 66.77%.

Nga shuma e përgjithshme e donacioneve prej 408,601.38€ nga Qeveria Norvegjeze (për SMIL), UNDP dhe GIZ, janë zotuar 267,364.89€ apo 65.43%, ndërsa janë shpenzuar 256,805.88€ apo 62.85%.

Për më shumë detaje rreth zotimit dhe realizimit të buxhetit për programet buxhetore të KGJK-së, shih tabelën:

Programet buxhetore të KGJK-së	Buxheti 2023	Buxheti i zotuar	Buxheti i zotuar %	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i shpenzuar %
Sekretariati i KGJK-së	29,854,622.42	28,544,903.85	95.61%	27,894,742.77	93.44%
NJIGJ	146,033.69	119,299.40	81.69%	118,949.60	81.45%
Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme	48,505.02	21,876.96	45.10%	21,827.26	45.00%
Gjykata Komerciale	54,000.00	42,292.24	78.32%	42,292.24	78.32%
Gjykata e Apelit	49,644.00	42,819.66	86.25%	42,807.96	86.23%
Gj.Th.Prishtinë	968,169.26	948,917.03	98.01%	936,690.56	96.75%
Gj.Th.Prizren	361,200.00	354,555.85	98.16%	352,174.14	97.50%
Gj.Th.Gjilan	333,754.00	332,354.32	99.58%	330,509.48	99.03%
Gj.Th.Ferizaj	258,700.00	253,493.82	97.99%	252,414.45	97.57%
Gj.Th.Pejë	320,200.00	313,622.06	97.95%	308,348.54	96.30%
Gj.Th.Gjakovë	199,600.00	191,743.45	96.06%	191,743.45	96.06%
Gj.Th.Mitrovicë	294,171.00	290,188.00	98.65%	289,297.39	98.34%
Totali	32,888,599.39	21,704,750.09	95.64%	30,781,797.84	93.59%




13.2 Të hyrat gjyqësore

Të hyrat gjyqësore të gjeneruara nga sistemi gjyqësor janë gjithsej 10,191,248.44€.

Realizimi i të hyrave gjyqësore është 100.76% më i lartë në krahasim me planifikimin (parashikimin) vjetor fillestar për vitin 2023 prej 10,114,242.00€. Në krahasim me vitin e kaluar ka pasur rritje në arkëtimin e të hyrave prej 369,650.88€ apo 3.76%.

Për më shumë detaje lidhur me të hyrat gjyqësore, shih tabelën:

Lloji i të hyrave	Shuma sipas llojit	Pjesëmarrja në %
Taksat e gjykatës	3,331,580.23	32.69%
Gjjobat e trafikut	1,123,421.27	11.02%
Gjjobat e gjykatës	5,209,868.94	51.12%
Taksë për kompensimin e viktimave të krimit	22,8978	2.25%
Taksë për aplikim	28,950.00	0.28%
Taksë për licencë - shërbime profesionale	268,450.00	2.63%
Totali	10,191,248.44	100%



PJESA E GJASHTË

14. TË ARRITURAT DHE SFIDAT E SISTEMIT GJYQËSOR

14.1 Përmbushja e Planit të Punës

Me qëllim të forcimit të qasjes së publikut ndaj shërbimeve gjyqësore, gjatë këtij viti, sistemi gjyqësor ka ndërmarr edhe një hap tjetër të rëndësishëm. KGJK bazuar në mandatin e vet kushtetues dhe ligjor, ka funksionalizuar Degën në Fushë Kosovë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke ofruar shërbime gjyqësore për Komunën e Fushë Kosovës dhe Obliqit.

KGJK ka përfunduar me sukses fazat e rekrutimit të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit tjetër profesional dhe administrativ, duke shtuar numrin e tyre me qëllim të forcimit të kapaciteteve të sistemit gjyqësor.

Është rritur efikasiteti në trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve në pritje për më shumë se 24 muaj dhe rasteve të natyrës prioritare sipas ligjit, të cilat janë në procedurë gjyqësore, duke vazhduar implementimin e Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022 - 2025, lidhur me Efikasitetin dhe Prioritizimin e lëndëve brenda sistemit gjyqësor.


Po ashtu, me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve të përkthimeve në sistem gjyqësor, Këshilli pas përfundimit me sukses të proceseve vlerësuese ka vazhduar certifikimin e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë për 152 kandidatëve të rinj, të cilët janë certifikuar dhe emëruar nga KGJK. Po ashtu, janë ricertifikuar edhe 325 kandidatë, prej të cilëve 135 kandidatë janë ricertifikuar si përkthyes gjyqësorë, ndërsa 190 kandidatë janë ricertifikuar si përkthyes dhe interpretë gjyqësorë për 23 çifte të gjuhëve.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, KGJK ka përfunduar procesin e certifikimit dhe emërimit të ekspertëve gjyqësor, duke emëruar mbi 1000 ekspertë gjyqësor në lëmi të ndryshme, me qëllim të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të gjykatave.



Implementimi i Planit të Punës i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Nga gjithsej 35 aktivitete të planifikuara, KGJK ka përmbushur 83% prej tyre.



Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me qëllim të përmbushjes së mandatit të vet kushtetues dhe ligjor gjatë vitit 2023 ka realizuar një sërë aktivitete, përmes hartimit dhe miratimit të këtyre akteve:

- ✓ *Plani Strategjik 2023 - 2025;*
- ✓ *Plani i Punësimit një dhe pesë vjeçar;*
- ✓ *Plani Strategjik i TI-së të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2024 - 2029;*
- ✓ *Plani i veprimit lidhur me Ekzekutimin e Lëndëve në Gjykata 2024 - 2025;*
- ✓ *Plani i veprimit për trajnimin e gjyqtarëve;*
- ✓ *Kodi i Etikës për Përkthyes dhe Interpret Gjyqësor të Certifikuar dhe Emëruar;*
- ✓ *Doracaku për punën e përkthyesve dhe interpretëve në sistemin gjyqësor të Kosovës.*

Aktivitetet:


- Implementimi i të gjitha masave për zbatimin e Planit Kombëtar për Integrim Evropian **100%**
- Implementimi i 12 masave nga 13 në Agjendën për Reformën Evropiane;
- Adresimi i rekomandimeve të dalura nga Komiteti VI për Stabilizim Asocim BE - Kosovë dhe Nën-komiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri;
- Adresimi i rekomandimeve të Misionit Vlerësues për rastet e Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar dhe Misionit Vlerësues për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve sipas shortit, ngritjes në detyrë dhe mandat fillestar;
- Me ndryshimet ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli ka arritur të miratoj aktet nënligjore që kanë rrjedhur si obligim i këtyre ndryshimeve;
- Avancimi i procedurave të rekrutimit për pëzgjedhje të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit tjetër administrativ;
- Vazhdimi i implementimit të Planit të Veprimit 2021-2023 lidhur me Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021-2026;
- Vazhdimi i implementimit të Strategjisë për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi;
- Vazhdimi i implementimit të Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimet të organizuar 2022-2024;
- Promovimi dhe monitorimi i zbatimit të Udhëzuesit për Politika Ndëshkimore për të siguruar shkallë më të lartë të uniformitetit në shqiptimin e dënimeve nga gjykatat;
- Rritja e shfrytëzimit të ndërmjetësimit si mjet alternativ për zgjidhjen e lëndëve;
- Propozimi për zhvillimin e sistemit E-falimentimi dhe themelimi i grupit punues për hartimin e specifikave dhe zhvillimin e konceptit për këtë sistem;
- Propozimi për krijimin e platformës së veçantë për centralizimin e shërbimeve të përkthimit në sistemin gjyqësor të Kosovës;
- Autorizimi i gjykatave themelore për fillimin e procesit të asgjësimit të regjistrave dhe lëndëve gjyqësore për vitin 2017;
- Fillimi i implementimit të projektit "Funksionalizimi i Qendrave për Monitorimin e Kamerave" në objektet e gjykatave themelore;
- Finalizimi i kërkesave funksionale dhe termat e referencës për 'Sistemin për Menaxhimin e Buxhetit, Shpenzimeve, të Hyrave dhe Pasurisë për KGJK dhe Gjykata';
- Vazhdimi i publikimit të vendimeve gjyqësore, vendimet disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe vendimet e Panelit për Lirim me Kusht, duke ndikuar në përmirësimin dhe ngritjen e transparencës së punës së gjyqësorit;

- Publikimi i listës me të dhënat e kompensimeve të personave të privuar nga liria padrejtësisht;
- Vazhdimi i mirëmbajtjes dhe përdorimi i Sistemit të Evidencës Penale;
- Vazhdimi i monitorimit në respektimin e afateve lidhur me dërgimin e lëndëve në gjykatën e shkallës së dytë dhe tretë;
- Planifikimi dhe mbajtja e trajnimeve për gjyqtarët porotë;
- Identifikimi i nevojave për trajnim të gjyqtarëve dhe zbatimi i planit të trajnimeve;
- Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike;
- Zbatimi i Opinioneve të Komitetit Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore;
- Plani për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare për Auditim;
- Formalizimi i procesit të krijimit të Zyrave për Informim dhe Komunikim me Media në KGJK dhe gjykata;
- Qasja e publikut përmes transmetimit të drejtpërdrejt të takimeve të KGJK-së dhe Asamblesë së kryetarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës;
- Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta të kryetarëve të gjykatave për avancimin e raporteve ndërmjet gjyqësorit me media, shoqërinë civile dhe publikun në Organizimim e ditëve të hapura për qytetarët;
- Evidentimi dhe inventarizimi i pasurisë.

Gjykatat themelore treguan performancë të mirë duke zgjidhur më shumë lëndë në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022, raportin statistikor të gjykatave për vitin 2023 mund ta gjeni në këtë link: [Raporti Statistikor](#) ✨

Në drejtim të avancimit të digjitalizimit dhe përmirësimit të shërbimeve digjitale në gjykata, aktivitetet kryesore të KGJK-së të realizuara përfshijnë:

- Themelimi i grupit punues për definimin e kriterëve për shpërdarjen automatike të lëndëve përmes SMIL për Gjykatën Komerciale;
- Miratimi i propozimit për zhvillimin e sistemit E-filing të rasteve civile, duke përfshirë ndryshimet në SMIL;
- Implementimi i projektit të audio dhe video incizimit;
- Fillimi i aktiviteteve për implementim të marrëveshjes për projektin për dosjen elektronike të gjyqtarëve;
- Fillimi i aktiviteteve për implementimin e sistemit për përkthimin e centralizuar në sistemin gjyqësor.



14.2 Sfidat

Gjatë vitit 2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përballur me këto sfida:

- Rishikimi dhe avancimi i formave standarde të aktgjykimeve dhe vendimeve gjyqësore;
- Unifikimi i praktikës gjyqësore;
- Sigurimi i lokacioneve për ndërtimin e objekteve të gjykatave të cilat kanë qenë në plan të punës;
- Menaxhimi jo i duhur i objektit të Pallatit të Drejtësisë nga institucioni përkatës që merret me menaxhimin e objekteve publike;
- Mungesa e hapësirave fizike në disa nga gjykatat e vendit, për zyre të gjyqtarëve dhe mbajtje të seancave;
- Gjendja e arkivave gjyqësore;
- Zgjatja e procedurave ankimore në proceset e prokurimit dhe vendimmarrjes në Organin Shqyrtues të Prokurimit lidhur me shërbimet dhe furnizimet për nevojat e gjyqësorit;
- Mos aprovimi i pozitive për rekrutimin e bashkëpunëtorëve profesionalë sipas kërkesave që dalin nga Ligji për Gjykatat, (një gjyqtar një bashkëpunëtor profesional), si dhe stafit tjetër mbështetës për funksionimin e punës së sistemit gjyqësor në përgjithësi;
- Mungesa e buxhetit për praktikantë gjyqësor;
- Impementimi i shërbimeve online për pagesat e taksave gjyqësore;
- Dërgimi i ftesave online të palëve për seancat gjyqësore;
- Përditësimi i politikave dhe procedurave të TIK;
- Zbatimi i SMIL në të gjitha procedurat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- Mungesa e administratorëve të sistemeve dhe sigurisë në Departamentin e Teknologjisë Informative;
- Mungesa e trajnimeve profesionale për stafin e TI-së në SKGJK dhe gjykata;
- Numri i madh i projekteve në fushën e TIK-ut në realizim në të njëjtën kohë;
- Monitorimi dhe mbikëqyrja e përdorimit të SMIL dhe NCCR, për të siguruar përdorimin e plotë dhe cilësinë e të dhënave;
- Trajnimi për administratën gjyqësore;
- Përmirësimi i menaxhimit të dosjes në mënyrë fizike;
- Mbikëqyrja dhe përmirësimi i shërbimit për shpërndarjen e shkresave;
- Mos ushtrimi i funksionit të gjyqtarëve nga komuniteti serb, i cila ka ndikuar në ngarkesën e përgjithshme me lëndë, si dhe performancën e gjykatave në përgjithësi;
- Vështirësitë që kanë dalur nga zbatimi i Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, në veçanti në harmonizimin e koeficienteve;
- Ndryshimet e reja legjislative, me theks të veçantë në fushën e rekrutimit dhe disiplinimit të stafit administrativ, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik;
- Mungesa e plotësimi të pozitive për gjyqtar, staf profesional dhe administrativ, si dhe mos zbatimi i SMIL-it në Gjykatën Komerciale;
- Pranimi i numrit të madh të padive nga lëmia civile në gjykatat e vendit që rrjedhin nga Kontratat Kolektive dhe aktet e brendshme të institucioneve, lidhur me kompensimet dhe shtesat nga marrëdhënia e punës;
- Mungesa në përgjithësi e stafit gjyqësor dhe profesional në të gjitha gjykatat e vendit.



Rr. Luan Haradinaj
133, Prishtinë



kgjk@rks-gov.net
www.gjyqesori-rks.org